

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

FAKULTETI JURIDIK
STUDIME PASDIPLOMIKE- CIKLI I DYTË

TEZA:

**“Keqpërdorimi i detyrës zyrtare-me theks të posaçëm në rrethin e
gjykatës themelore Tetovë për periudhën
2014-2018”**

KANDIDATI :

Adelina Ibrahim

MENTORI:

Prof.Dr. Ismail Zejneli

Tetovë, 2020

Deklarata e autorësisë

Nën përgjegjesinë time personale, deklaroj se përmbajtja e temës së magjistraturës së paraqitur është punë origjinale e shkruar prej meje, e cila nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Të gjitha referencat dhe citimet në tekst janë bërë në bazë të burimeve të paraqitura në fusnota.

Me respekt _____ ()

Falënderim

Për çdo arritje dhe sukses falënderimi i takon Allahut!

Falënderim i veçantë për mentorin tim Prof. Dr. Ismail Zejneli, i cili me këshillat, sugjerimet dhe ndihmën profesionale mundësoi finalizimin me sukses të këtij punimi.

Falënderim i pafund për njerëzit e mi të dashur për mbështetjen, durimin, ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme e veçanërisht gjatë periudhës së studimeve. Mirënjohëse dhe shumë falënderuse juve që gëzoni me mua dhe krenoheni me sukseset e mia.

Përmbajtja

ABSTRAKT	6
HYRJE	7
Kapitulli I-rë	9
1. Kuptimi i veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare	9
2. Aspekte historike të veprave penale të keqpërdorimit të detyrës.....	13
3. Aspekte krahasuese të veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare	15
3.1 Vepra penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.....	16
3.2 Vepra penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës	20
3.3 Vepra penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare sipas legjislacionit të Republikës së Kroacisë	25
Kapitulli II-të	29
1. Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar	29
2. Të punuarit e pandërgjegjshëm gjatë detyrës.....	34
3. Keqpërdorimi i shërbimit	35
4. Marrja e ryshfetit	36
5. Dhënia e ryshfetit.....	40
6. Fitimi i kundërligjshëm dhe pasuria e fshehur.....	43
7. Falsifikimi i dokumenteve zyrtare	45
Kapitulli III-të	48
1. Parandalimi i veprave penale kundër detyrës zyrtare.....	48
2. Roli i policisë në parandalimin e veprave penale kundër detyrës zyrtare.....	49

3. Roli i prokurorisë në parandalimin e veprave penale kundër detyrës zyrtare	52
4. Roli i gjykatave në parandalimin e veprave penale kundër detyrës zyrtare	55
5. Roli i mas-mediave në parandalimin e veprave penale kundër detyrës zyrtare	58
Kapitulli IV-të.....	60
1. Raset nga praktika gjyqësore.....	60
2. Raset nga praktika gjyqësore marrja e ryshfetit.....	65
3. Raset nga praktika gjyqësore shpërdorim i shërbimit	66
4. Raset nga praktika gjyqësore falsifikimi i dokumentit zyrtar	67
Përfundim	68
Literatura.....	71

ABSTRAKT

Keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimit paraqet një formë të veçantë të kriminalitetit. Kryerësit e kësaj vepre penale duke shfrytëzuar autorizimet e dhëna nga pozita e caktuar përfitojnë për vete apo për dikë tjetër, apo do të shkaktojnë dëm të caktuar. Fenomeni i tillë i vënies së interesit personal mbi interesin shoqëror paraqet një dukuri gjithmonë në rritje të vazhdueshme, mirëpo masat që ndërmerren për zbulimin, parandalimin dhe ndëshkimin e këtyre veprave penale janë të pakta dhe jo shumë efikase. Për këtë arsye një ndër qëllimet kryesore të këtij punimi është hulumtimi i masave që ndërmerren ndaj këtyre veprave, sa janë efikase ato dhe a kanë treguar rezultate.

Në këtë tezë do të hulumtohen në mënyrë të veçantë llojet e këtyre veprave penale, kuptimin e tyre, aspekte historike të paraqitjes dhe zhvillimit të këtyre veprave, aspekte krahasuese me legjislacionet e vendeve fqinje. Rëndësi të posaçme do ti kushtohet parandalimit të kësaj dukurie shumë të përhapur, masat të cilat ndërmerren nga organet e prokurorisë, policisë dhe gjykatave dhe ndikimin e mediave që kjo dukuri të vihet në dukje dhe të luftohet në mënyrë adekuate.

Në kapitullin e IV-të dhe të fundit do të analizohen rastet e keqpërdorimit të detyrës zyrtare në territorin e Gjykatës Themelore të Tetovës në periudhën kohore 2014-2018.

HYRJE

Në këtë punim lëndë e hulumtimit do të jenë veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga personat zyrtar. Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare i kryejnë persona zyrtarë përgjegjës që duke shfrytëzuar pozitën dhe autorizimin e vetë zyrtar, me tejkalim të kufijve të autorizimit të vetë zyrtar apo me mos zbatimin e detyrës së vetë zyrtare do të përfitojnë për vete apo për tjetër kënd ndonjë dobi ose tjetërkujt do t'i shkaktoj dëm.

Në këtë tezë do të hulumtohen në mënyrë të veçant llojet e këtyre veprave penale, kuptimin e tyre, aspekte historike të paraqitjes dhe zhvillimit të këtyre veprave, aspekte krahasuese me legjislacionet e vendeve fqinje.

Për hulumtimin, kërkimin dhe studimin e rasteve lidhur me këtë punim do të shfrytëzohen kryesisht metoda normative, historike, krahasuese dhe statistikore.

Ky punim është ndarë në katër kapituj, në kapitullin e parë kemi një paraqitje të përgjithshme të kuptimit të këtyre veprave penale, çka paraqesin, si i parasheh legjislacioni vendas këto vepra penale, kush janë kryerës të këtyre veprave penale, etj. Në këtë kapitull elaborohen edhe aspekte historike të keqpërdorimit të detyrës zyrtare si vepër penale dhe aspekte krahasuese duke bërë krahasimin me legjislacionet e vendeve fqinje, dhe atë të R. Shqipërisë, R. Kosovës dhe R. Kroacisë.

Në kapitullin e dytë në mënyrë të detajuar janë paraqitur disa nga veprat e paraparë në kuadër të Kapitullit XXX të Kodit Penal të RMV-së.

Në kapitulli e tretë rëndësi të posaçme do ti kushtohet parandalimit të kësaj dukurie shumë të përhapur, masat të cilat ndërmerren nga organet e prokurorisë, policisë dhe gjykatave dhe ndikimin e mediave që kjo dukuri të vihet në dukje dhe të luftohet në mënyrë adekuate.

Mungesa e të dhënave për këto vepra penale , mos paraqitja e tyre dhe mos ndjekja adekuate nga organet kompetente bën që këto vepra penale në të shumtën e rasteve të mbeten të pandëshkuara.

Në kapitullin e katërt duke u mbështetur në të dhënat statistikore të siguruara, hulumtimi i rasteve nga praktika gjyqësore në Gjykatën Themelore në Tëtovë, jam munduar të paraqes një pasqyrë për periudhën 2014-2018, sa është prezente kjo vepër penale në rrethin e kësaj gjykate në këtë periudhë, llojet e veprave penale , llojet e dënimeve, etj.

Kapitulli I-rë

1. Kuptimi i veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare

Me qëllim që të mundësohet sundimi i ligjit dhe kufizimi i fuqisë shtetërore, Kodi Penal i RMV-së në kapitullin e XXX ka paraparë veprat penale kundër detyrës zyrtare. Karakteristikë themelore e këtyre veprave penale është ajo që gjithmonë kanë për qëllim keqpërdorimin e pozitës dhe autorizimeve zyrtare nga personat zyrtar për përfitimin e ndonjë dobie apo për ti shkaktuar dikuj dëm.

Në Kodin Penal të RMV-së vepra penale “Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar” është paraparë në nenin 353 të kreut XXX-të.

Paragrafi 1 i këtij neni këtë vepër penale e definon: “personi zyrtar i cili me shfrytëzimin e pozitës apo të autorizimit të vet zyrtar, me tejkalimin e kufijve të autorizimit të vet zyrtar apo me moszbatimin e detyrës së vet zyrtare do të përfitojë për vete ose për tjetërkënd ndonjë dobi ose tjetërkujt do t’i bëjë dëm, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet”.¹

Personat përgjegjës janë të detyruar që autorizimet publike dhe detyrat ti kryejnë në përputhje me kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare.

Secili është i detyruar që gjatë kryerjes së funksionit, autoritetit publik, detyrave zyrtare dhe pozitës, të veprojë me ndërgjegje, profesionalizëm, me përgjegjësi, në mënyrë më efikase dhe të paanëshme. Askush nuk mund që kryerjen e funksionit, autoritetin publik, detyrat zyrtare dhe pozitën si dhe çështjet me interes publik, ti përdorë për arritjen e qëllimeve personale.²

Dukuritë e këtilla, që përbëjnë një të keqe të madhe për çdo shoqëri janë karakteristikë si për shoqëritë e vjetra, ashtu edhe për shoqëritë bashkëkohore. Rrezikshmëria e tyre qëndron veçanërisht në faktin se këto vepra penale i kryejnë personat që janë titullarë të autorizimeve

¹ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e RM-së” nr.28, datë 06.02.2014, neni 353, paragrafi 1.

² Ligji për pengimin e korrupsionit, Gazeta zyrtare e RMV-së, nr, 28/02, 46/04, 126/06, 10.01.2007, Neni 3.

zyrtare, dhe kjo përbën sulm mbi integritetin e detyrës nga brenda. Ky veprim rrit njëkohësisht mundësinë e fshehjes së kësaj forme të kriminalitetit.³

Kryerësit e veprave penale të korrupsionit rëndom nuk janë nga radhët e kriminalitetit klasik, por janë përfaqësues të shtresave më të larta shtetërore, ata janë persona në pozita dhe me autoritet, titullarë funksionesh të larta shtetërore dhe ekonomike me autorizime të caktuara, persona në vende përgjegjëse, etj. Zakonisht, kryerësit më të shpeshtë të këtyre veprave penale janë personat zyrtarë që ushtrojnë një funksion të caktuar në organet shtetërore, në shërbimet publike, në institucionet dhe entet e tjera publike, të cilat vendosin për të drejtat dhe detyrat e qytetarëve dhe të personave juridik.⁴

Varësisht nga statusi i kryerësit, veprat penale kundër detyrës zyrtare mund të ndahen në vepra penale speciale dhe vepra penale të përgjithshme (*delicta propria et delicta communia*). Numri më i madh i veprave penale të këtij lloji hyjnë në grupin e parë dhe si kryerës të tyre paraqiten vetëm personat zyrtarë, ndërsa te një numër i tyre, përpos personave zyrtarë, si kryerës mund të paraqiten edhe personat përgjegjës. Në veprat e përgjithshme të këtij grupi hyn edhe vepra penale e dhënies së ryshfetit, e cila mund të kryhet nga çdo person, si dhe vepra penale e ushtrimit të ndikimit.⁵

Këto vepra penale mund të kryhen vetëm me dashje. Kjo rezulton nga natyra e këtyre veprave penale, te të cilat më së shpeshti bëhet fjalë për veprimin e vullnetshëm dhe të pandërgjegjshëm gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, shpesh me qëllim të përfitimit të dobisë së caktuar.

Kodi penal i RMV-së nuk e definon nocionin e përgjithshëm të dashjes, por përcakton kuptimin e dy llojeve të saj: dashjes direkte dhe asaj eventuale. Elementet e përbashkta të dashjes direkte dhe eventuale janë vetëdija dhe vullneti për kryerjen e saj, te dashja direkte e përcaktuar si dëshirë për kryerjen e veprës , kurse të dashja eventuale si pajtim me pasojën e

³ I. Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1203.

⁴ Po aty, fq.1206.

⁵ Po aty, fq.1208.

saj. Në bazë të këtyre elementeve dashja përkufizohet si kryerje e vetëdijshme dhe e dëshirueshme e veprës penale.⁶

Përfundim bën vepra penale e zbulimit të sekreteve zyrtare, për të cilën është parashikuar përgjegjësia penale edhe për pakujdesi.⁷

Sipas nenit 360 përgjegjës është dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet “ai i cili publikut apo personit të pathirrur do ti kumtojë, dorëzojë apo në ndonjë mënyrë tjetër do t’ia bëjë të arritshme të dhënat që paraqesin fshehtësi zyrtare apo grumbullon të dhëna të tilla me qëllim që t’i kumtojë apo dorzojë publikut apo personit të pathirrur”.⁸

Është thënë se veprat e këtilla, në esencë janë vepra të keqpërdorimit të detyrës dhe autorizimeve zyrtare në kryerjen e detyrës zyrtare. Mirëpo, këto janë edhe vepra të tilla penale, me të cilat çënohen vlera të ndryshme, siç janë liritë individuale të individit, pasuria e tij, etj.⁹

Në raste të tilla krijohen probleme të caktuara në përcaktimin e objektit të mbrojtur të veprave të këtilla. Kështu, disa autorë flasin se te këto vepra penale nuk mund të bëhet fjalë për një objekt unik të mbrojtur, po për një objekt të shumëfishtë të mbrojtur. Edhe pse me veprat e këtilla rrezikohen vlera të ndryshme individuale, nga natyra dhe kuptimi i këtyre veprave rezulton se objekt i tyre primar i mbrojtur është ushtrimi i ligjshëm, i drejtë dhe me ndërgjegje i detyrës dhe i autorizimeve zyrtare. Pra, bëhet fjalë për interesin e përgjithshëm të shoqërisë dhe të çdo qytetari, që shërbimet shtetërore dhe shërbimet e tjera me interes publik të funksionojnë ligjërisht dhe drejt, ngase vetëm kështu zyrtarët/shërbimet përmbushin funksionin e tyre shoqëror. Funksionimi i pastër, i drejtë, i ndershëm dhe i ligjshëm i organeve shtetërore dhe organeve të tjera publike, janë parakushte të domosdoshme për funksionimin e tyre efikas dhe me autoritet.¹⁰

⁶ Kambovski, Vllado, E Drejta Penale-Pjesa e Përgjithëshme, Shkup, 2010, fq.269.

⁷ I. Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1208.

⁸ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e RM-së” nr.28, datë 06.02.2014, neni 360.

⁹ I. Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1203.

¹⁰ Po aty, fq.1204.

Nocioni i korrupsionit buron nga gjuha latine – fjala “corrumpire”, që do të thotë të thyesh, të prishësh, të dëmtosh, të shkatërrosh moralin, ndërgjegjen e një personi në marrëdhënie me një tjetër që kryen një detyrë apo funksion publik.

Në të vërtetë nocioni i korrupsionit ka pësuar evolucionin e tij gjatë shekujve.

Korrupsioni në kuptimin më të gjërë paraqet çfarëdo lloji keqpërdorimi të pozitës nga ana e nëpunësit shtetëror apo personi që ushtron ndonjë funksion publik të caktuar, e cila ka për qëllim shfrytëzim material personal.¹¹

Ligji për pengimin e korrupsionit në nenin 1 e definon atë si: “shfrytëzim i funksionit, autorizimit publik, detyrës zyrtare dhe autorizimit me qëllim të shfrytëzimit të çfarëdo fitimi për vete apo për tjetrin”.¹²

LPK i vërteton masat për pengimin e korrupsionit gjatë qeverisjes dhe gjatë kryerjes së autorizimeve të besuara publike, masat për pengimin e konfliktit të interesave, si dhe masat për pengimin e korrupsionit gjatë kryerjes së punëve në interes publik të personave juridik të ndërlidhur me realizimin e qeverisjes.¹³

Nocioni korrupsion nga aspekti juridiko-penal është relativisht i ngushtë. Ai përfshin inkriminimet për ryshfet pasiv dhe aktiv, ndërmjetësim kundërligjor dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare për realizim të të mirave për vete apo për tjetrin.

Korrupsioni në gjithë vendet e botës e veçanërisht në vendet në zhvillim dhe tranzicion, siç është Republika e Maqedonisë së Veriut paraqet problem serioz ekonomik dhe politik.

Keqpërdorimi i detyrës zyrtare, vepra e marrjes dhe dhënies së ryshfetit paraqesin pengesat kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, politik dhe shoqëror.

¹¹ Grup autorësh, Kriminaliteti i organizuar-aspekte juridike, Tetovë, 2009, fq.190.

¹² Ligji për pengimin e korrupsionit, Gazeta zyrtare e RMV-së, nr, 28/02, 46/04, 126/06, 10.01.2007.

¹³ Grup autorësh, Kriminaliteti i organizuar-aspekte juridike, Tetovë, 2009, fq.191.

2. Aspekte historike të veprave penale të keqpërdorimit të detyrës

Dukuria e keqpërdorimit të pozitës dhe autorizimeve zyrtare dhe në përgjithësi, veprimi i kundërligjshëm i personave zyrtarë, veçanërisht korrupsioni, janë të njohura dhe të inkriminuara kaherë në të drejtën penale. Mirëpo sistematizimi në të ashtuquajturat vepra penale zyrtare dhe radhitja e tyre në grupe të posaçme, ka ndodhur mjaft vonë, më saktë në legjislacionin penal të shekullit XIX. Prej atëherë ka filluar edhe përpunimi i rëndësishëm teorik i këtyre veprave penale.¹⁴

Veprat penale kundër detyrës zyrtare përbëjnë sjellje të kundërligjshme, fenomen ky i cili ka tërhequr gjithmonë vëmendjen e qarqeve shkencore. Kjo dukuri e keqpërdorimit të detyrës dhe autorizimit apo keqpërdorimit të vendit të punës që në kuandër të saj përfshin atë që quhet korrupsion në kontekst të gjërë, kurse në legjislacione të ndryshme të vendeve parashihet si “keqpërdorim i detyrës zyrtare” apo specifikohet në mënyra të ndryshme.

Që nga miratimi i Kodit të parë Penal të RMV-së i njeiti ka hasur ndryshime dhe reforma, këto ndryshime ende vazhdojnë. Reforma këto të cilat bëhen si rezultat i kushtëzimit nga Bashkimi Evropian për harmonizim të legjislacionit penal maqedonas me të drejtën penale evropiane dhe legjislacionet e vendeve antare të UE-së.

Faza e dytë e reformimit të Kodit Penal e njohur si Novela e KPM-së rezultoi me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të KPM-së të miratuar në vitin 2004. Me këtë ligj edhe në pjesën e posaçme ka pasur ndryshime. Ndryshim i rëndësishëm në kuptim të zgjerimit të përshkrimit ligjor dhe të formave tjera të veprave penale kemi edhe nenin 353b - Keqpërdorimi i detyrës zyrtare me punë jo të ndërgjegjshme.¹⁵

Korrupsioni edhe më tej mbetet një problem me prioritet të lartë për Republikën e Maqedonisë së Veriut.

¹⁴ I. Salihu, H. Zhitija, F. Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1203.

¹⁵ Kambovski, Vllado, E Drejta Penale-Pjesa e Përgjithëshme, Shkup, 2010, fq.57.

Është e qartë se aktivitetet e ndërmarra nga autoritetet janë të pamjaftueshme, dhe institucionet janë joefektive. Mangësitë në sundimin e ligjit shkaktojnë mosbesim tek qytetarët në gjyqësi dhe kuvend, si institucione të cilat duhet të sigurojnë garantimin e sundimit të ligjit, mbrojtjen e interesit publik dhe një shtet me prosperitet. Institucionet deri më tani nuk kanë siguruar garancë të mjaftueshme se ata që janë përgjegjës për korrupsionin dhe veprimeve të paligjshme nuk do të gëzojnë mbrojtje dhe do të ndëshkohen. Paprekshmëria e përgjegjësve të korrupsionit është përditshmëri e cila duhet të çrrënjohet.

Edhe në shtetet demokratike ku qeveria dhe institucionet e shtetit janë transparente me qytetarin, ka një shpeshim të organizatave të ndryshme joqeveritare, të cilat po i kontribuojnë rritjes së një ambienti anti-korruptiv. Në shkallë botërore, një prej këtyre organizatave mjaft të suksesshme është “Transparency International”.

Kontributi i OKB-së pas Luftës së Dytë Botërore, kryesisht shprehet me aktivitete të ndryshme në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit, kryesisht duke aprovuar një numër të madh të konventave dhe akteve të tjera ndërkombëtare.

Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimeve të cilat u janë besuar për çështje kriminale nuk cilësohet si një fenomen i ri, por që në kohëra të lashta ka qenë një shqetësim për shtetin dhe shoqërinë. Kjo vepër penale gjithmonë ka qenë prezent në të gjitha shoqëritë dhe gjithmonë është alarmuar si një dukuri e rrezikshme dhe problematike nga qarqet shkencore, nga autorë e gazetarë.

Globalizimi gjithnjë më i hovshëm i cili jep dimensione të reja në raporte ekonomike, politike e në tërësi të raportet shoqërore, ka hapur dhe vazhdon të hapë shtigje të reja, për mundësitë e keqpërdorimit të autoritetit. Kjo dukuri sot është më shumë prezente së kurdoherë. Mirëpo avancimi i teknologjisë aq sa është në favor të kësaj dukurie, po aq e favorizon edhe mundësinë e zbulimit të këtyre veprave penale.

Karakteristikë themelore e këtyre veprave penale përbën pikërisht cënimi i detyrës zyrtare. Statusi juridiko-publik i shërbimit, rëndësia e autorizimeve që rezultojnë për individët nga pozita e tyre zyrtare, një person të këtillë e detyrojnë të ketë një vigjilencë të shtuar për veprim

të ligjshëm, për shfrytëzim të ligjshëm të të drejtave dhe autorizimeve të tij, prandaj veprat penale këtu qëndrojnë në cënimin e rëndë të pozitës apo autorizimit në kryerjen e detyrës zyrtare. Për këtë arsye, te veprat e tilla penale është fjala për cënimin e integritetit të shërbimit nga vetë bartësit e autorizimeve zyrtare, (për sulm mbi shërbimin nga brenda), nga vetë personat zyrtarë. Cënimi i këtillë i detyrave zyrtare përbën vepra të rrezikshme shoqërore, me të cilat atakohen të mirat juridike të bashkësisë dhe individit.¹⁶

Madje në shumë vende, ndonëse dikush në mënyrë të vazhdueshme po keqpërdorë autoritetin e besuar nga ana e shoqërisë përmes institucioneve të shtetit, vazhdon të ketë mbrojtje përderisa keqpërdoruesi është pjesë e pushtetit.

Ky lloj i krimit përfshin elita të tëra politike , prandaj vlen shprehja “ku ka fuqi, nuk ka drejtësi”.

3. Aspekte krahasuese të veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare

Me më shumë ose më pak dallime, veprat penale kundër detyrës zyrtare sanksionohen në të gjitha legjislacionet penale bashkëkohore.¹⁷

Që nga shekulli XVIII, lëvizja komparatiste zhvillohet në mënyrë të konsiderueshme. Duke nisur nga fillimi i shekullit XIX kristalizohen qartë edhe debati dhe studimi për të.¹⁸

E drejta penale e krahasuar mundëson njohjen më të mirë të së drejtës penale në përgjithësi. Çdo vend nuk posedon në një moment të caktuar veçse një infrastrukturë të së drejtës së saj penale e cila nuk mund të qëndrojë e pandryshueshme për një kohë shumë të gjatë.

Doktrinat e mëdha penale nuk mund të njihen, veçse nëpërmjet një afrimi, përqasjeje dhe në të njëjtën kohë përballje ndërmjet tyre. Krahasimi e bën më modest juristin e një vendi, lidhur me standardet e drejtësisë në vendin e tij, mundësia e eksplorimit të institucioneve të huaja mban

¹⁶ Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1204.

¹⁷ Po aty, fq.1203.

¹⁸ Shegani.A, E drejta Penale e Krahasuar, Tiranë, 2002, fq.18.

në vete riskun ose shansin që të mund të zbulojë gjëra shumë të mira në një sistem penal të huaj, të vlefshme për tu aplikuar.¹⁹

Juristi që krahason shkon përtej studimit të skemave të funksionimit të një të drejte meqënëse me anë të përballjes të dy ose më shumë të drejtave, ai kërkon të nxjerrë aspektet e përbashkëta dhe të veçanta.

3.1 Vepra penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare janë paraparë në kreun VIII, përkatësisht në sesionin e dytë të titulluar “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik”.

Vepra penale Shpërdorimi i detyrës është rregulluar me nenin 248 të Kodit Penal të RSH-së dhe parasheh “kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.²⁰

Vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën - Neni 135

Vjedhja e pasurisë e kryer nga personi, që ka për detyrë ta ruajë dhe ta administrojë atë, apo duke shpërdoruar detyrën, dënohet me burgim deri në dhjetë vjet.

Sipas nenit 135 të Kodit Penal të RSH-së që parashikon veprën “vjedhje duke shpërdoruar detyrën”, me nocionin “ruajtje të pasurisë” kuptojmë mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e pasurisë, me qëllim që të mos e sulmojnë, dëmtojnë apo vjedhin atë, me nocionin “administrim” të pasurisë do të kuptojmë kujdesin e treguar për pasurinë, që ajo të përdoret mirë sipas

¹⁹ Shegani.A, E drejta Penale e Krahasuar, Tiranë, 2002, fq.16.

²⁰ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, gusht 2017, neni 248.

rregullave ose sipas nevojave për ruajtjen e asaj pasurie, në bazë të drejtimit dhe organizimit të punës në një fushë të caktuar, në bazë të rregullave teknike dhe ligjeve përkatëse të shtetit.

Në tabelën në vazhdim kemi një paraqitje statistikore zyrtare për këtë vepër penale nga Instituti i Statistikave (INSTAT) për periudhën kohore 2015-2018.²¹

Tabela 1: Vepra penale duke shpërdorur detyrën në Republikën e Shqipërisë në periudhën 2015-2018.

Burimi : INSTAT

	Vjedhje duke shpërdoruar detyrën			
	2015	2016	2017	2018
Vepra penale të evidentuara	150	81	118	70

Dallim i shpërdorimit të detyrës nga ai i krimin të korrupsionit është bërë i qartë në doktrinën e së drejtës penale (pjesa e posaçme). Këto figura krimi janë më vete, por kur shpërdorimi i detyrës shoqërohet me korrupsion atëherë kemi konkurim të tyre.

Në bazë të analizës së elementeve përbërëse të figurës së veprës penale bëhet edhe cilësimi juridik i drejtë dhe i saktë i veprës penale që shërben për të bërë dallimin kur ka konkurim apo vepra penale të përafërta, si psh. korrupsioni me shpërdorimin e detyrës.

Në veprën penale të shpërdorimit të detyrës, personi që ushtron funksione publike kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta, vepron në kundërshtim me ligjin. Ndërsa në veprën penale të korrupsionit pasiv personi kërkon ose merr përfitime për të kryer ose mos kryer një veprim që ka lidhje me detyrën por nuk vepron në kundërshtim me detyrën e tij.

Fjala korrupsion është një term i paqartë. Edhe në literaturën profesionale përmban kuptime të ndryshme dhe të padefinuara. Ky definicion është i llojllojshëm.

²¹http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sg/DST/START_CRIME_CRIOFFPRO/CR01/table/tableViewLayout2/?rxid=ca0d97d1-4bc5-490e-b0fc-722c04fd6463 vizituar më 25.06.2020.

Pas kalimit të Shqipërisë në pluralizmin politik, në vitin 1995 doli Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Në kod parashikoheshin vetëm dy figura krimi të korrupsionit:

a. Kërkimi për mitëmarrje;²²

b. Marrja e mitës.²³

Mitëdhënia nuk parashikohej si krim me motivacionin se personi që jepte mitë nuk mund të denonconte vetveten. Kufizimi i kriminalizimit vetëm të dy vepra penale të korrupsionit nuk ishte efektiv për luftimin e tij, derisa në këtë krim ka marrëveshje midis mitëmarrësit e mitëdhënësit, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë duhen dënuar si mitëmarrësi, ashtu dhe mitëdhënësi.²⁴

Mangësi këto që u plotësuan me reformën ligjore të vitit 2004, me ligjin nr. 9275 datë 16.09.2004, bazuar në Konventën Penale për korrupsionin të Këshillit të Europës (Strasburg 1999), ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8778 datë 26.04.2001.

Me këtë ligj u bë unifikimi i terminologjisë me atë të Konventës, duke zëvendësuar termin marrja e mitës me termin “korrupsion pasiv” dhe të mitëdhënies me termin “korrupsion aktiv”. Por më kryesorja ishte se me ligjin e vitit 2004 u kriminalizuan vepra të reja penale të korrupsionit aktiv e pasiv në sektorin privat (neni 164); korrupsioni aktiv e pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike (nenet 244 e 259); korrupsioni i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë (nenet 245 e 260); korrupsioni aktiv e pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë.

²² Neni 259 “Kërkim për dhënie mite - Kryerja e veprimeve nga punonjësi i ngarkuar me funksion shtetëror apo në shërbim publik, për të kërkuar ose urdhëruar dhënien e shpërblimeve që nuk i takojnë ose më shumë nga sa i takojnë sipas ligjit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në shtatë vjet”.

²³ Neni 260 “Marrja e mites - Marrja e shpërblimeve, dhuratave ose përfitimeve të tjera prej punonjësit të ngarkuar me një funksion shtetëror apo në shërbim publik e në ushtrim të tyre, për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me funksionin apo shërbimin ose për të përdorur ndikimin pranë autoriteteve të ndryshme për t’i siguruar çdo personi favorizime, dallime, vende pune e përfitime të tjera, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”.

²⁴ Raport studimor për veprat penale të korrupsionit dhe formave të shpërdorimit të detyrës i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, 2014, fq.12.

Objekti (sendet) që jepen dhe merren në korrupsionin aktiv e pasiv mund të jenë të ndryshme, me vlera ekonomike. Këtu hyjnë paratë, çeku, letrat me vlerë, sende të tjera me vlerë, bileta transporti, shërbime të ndryshme, si transporti i mallrave, dhënia e apartamenteve për banim pa qera apo dhurimi. Në literaturë diskutohet nëse hyjnë në objekt të korrupsionit diplomat, librezat e punës etj. Nisur nga fakti se me diploma të universiteteve private furnizohen jo vetëm shqiptarë, por edhe të huaj mendohet se duhet të pranohen si objekt i korrupsionit.²⁵

Aktualisht Kodi Penal i Shqipërisë përmban 21 nene që kriminalizojnë e penalizojnë veprat penale të korrupsionit, kurse Konventa Europiane 13 nene (11 nga të cilat janë nën variante të tyre). Mirëpo në Kod nuk janë përfshirë rrethanat rrënduese të korrupsionit – i kryer nga një grup i strukturuar, me shtrëngim, në përpjestime të mëdha.

Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike - Neni 244

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë - Neni 244/a

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, nëpunësit të huaj publik, nëpunësit të një organizate publike ndërkombëtare, anëtarit të një asambleje të huaj publike apo anëtarit të një asambleje ndërkombëtare parlamentare, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim, nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë - Neni 245

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.

²⁵ Raport studimor për veprat penale të korrupsionit dhe formave të shpërdorimit të detyrës i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, 2014, fq.16.

Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike - Neni 259

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga personi që ushtron funksione publike, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj - Neni 259/a

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt a tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga nëpunësi i huaj publik, nëpunësi i një organizate publike ndërkombëtare, anëtar i një asambleje të huaj publike apo anëtar i një asambleje ndërkombëtare parlamentare, për të kryer ose për të mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet.

Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë - Neni 260

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet.²⁶

3.2 Vepra penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës

Veprat penale kundër detyrës zyrtare përbëjnë sjellje të kundërligjshme të drejtuara kundër funksionimit të rregullt të shërbimeve publike, të cilat i kryejnë personat e autorizuar apo personat zyrtarë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre zyrtare ose lidhur me kryerjen e detyrës zyrtare. Kjo formë e kryerjes së veprës penale sot bie në kategorinë e kriminalitetit me shkallë

²⁶Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, Gusht 2017, neni 260.

të lartë rreziku për shoqërinë. Kjo gjë manifestohet jo vetëm në pasojat materiale që rezultojnë nga kryerja e këtyre veprave penale, por sidomos në rrënimin dhe çrregullimin e rrjedhave themelore të jetës shoqërore, duke atakuar vlerat morale të shoqërisë. Nga vetë emërtimi i këtyre veprave penale rezulton se element esencial i këtyre veprave penale është cënimi i detyrës zyrtare nga ana e personave zyrtarë përmes shfrytëzimit të kundërligjshëm të pozitës dhe autorizimeve zyrtare që rrjedhin prej saj.

Për herë të parë në legjislacionin Kosovar veprat penale kundër detyrës zyrtare janë specifikuar me Ligjin mbi mbrojtjen e të mirave materiale të vitit 1946. Në këtë ligj trajtohet dhe specifikohet si vepër penale poashtu edhe marrja dhe dhënia e mitos.

Për herë të parë kjo dukuri do të trajtohet penalisht dhe do të inkriminohet si vepër penale në Ligjin mbi veprat penale kundër detyrës zyrtare të vitit 1948.

Me miratimin e Kushtetutës së vitit 1974 dhe fitimin e Autonomisë do të miratohet Ligji Penal i Krahinës Autonome të Kosovës në vitin 1977 ku do të rregullohet materia penale duke ofruar zgjidhje juridike për shumë çështje ndër të cilat edhe çështja e keqpërdorimit të detyrës zyrtare në kreun e njëzetë (XX) të këtij ligji.

Pas luftës Kosova mbet në një vakum, për këtë arsye u aprovua dhe hyri në fuqi Kodi i Përkohshëm Penal i cili veprave penale kundër detyrës zyrtare i kushton një kapitull të veçant (XXIX).

Në vitin 2012 Kuvendi i Republikës së Kosovës miraton Kodin Penal Nr. 04/L-082 ku ishin paraparë veprat penale kundër detyrës zyrtare. Normat ligjore të parapara në këtë Kod do të jenë në fuqi deri në vitin 2019 me miratimin e Kodit të ri Penal ku shfuqizohet Kodi Penal i vitit 2012.

Veprat penale kundër detyrës zyrtare të cilat sot janë në fuqi janë të parapara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës Nr. 06/L-074 miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2019.

Vepra penale e Keqpërdorimit të detyrës zyrtare në Kodin Penal të Republikës së Kosovës është e paraparë në kapitullin XXXIII të titulluar “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës

zyrtare” ku përcaktohen veprat penale në kuadër të kësaj natyre dhe atë :

- Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (neni 414);
- Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik (neni 415)
- Keqpërdorimi i informatës zyrtare (neni 416);
- Konflikti i interesit (neni 417);
- Përvetësimi në detyrë (neni 418);
- Mashtrimi në detyrë (neni 419);
- Përdorimi i pa autorizuar i pasurisë (neni 420);
- Marrja e ryshfetit (neni 421);
- Dhënia e ryshfetit (neni 422);
- Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj apo personave të huaj zyrtar (neni 423);
- Ushtrimi i ndikimit (neni 424);
- Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore (neni 425);
- Zbulimi i fshehtësisë zyrtare (neni 426);
- Falsifikimi i dokumentit zyrtar (neni 427);
- Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme (neni 428);
- Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor (neni 429);
- Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave , i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare (neni 430).²⁷

Ndarja e veprave penale të këtij kapitulli. Të gjitha veprat penale kundër detyrës zyrtare, pavarësisht se a gjenden në këtë grup apo në ndonjë grup tjetër, në teorinë e së drejtës penale ndahen në vepra penale të drejta dhe jo të drejta dhe në vepra të përgjithshme e të posaçme.

- Veprat penale zyrtare të drejta janë veprat penale, kryes i të cilave mund të jetë vetëm personi zyrtar, cilësia e personit zyrtar të të cilit është element konstitutiv – qenësor i

²⁷ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr 06/L-074, Gazeta Zyrtare E Republikës Së Kosovës , Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.

veprave të tilla. Nga kjo rezulton se këto vepra penale mund të konsumohen vetëm gjatë kryerjes së detyrës zyrtare dhe këto vepra penale, jashtë kësaj nuk ekzistojnë. Vepra të tilla janë p.sh. shpërdorimi i pozitës ose i autorizimit zyrtar, përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës, zbulimi i sekreteve zyrtare etj.

- Veprat penale zyrtare jo të drejta janë veprat kryes i të cilave, përpos personit zyrtar, mund të jetë edhe ndonjë person tjetër, i cili veprën e kryen jashtë detyrës zyrtare apo lidhur me kryerjen e detyrës zyrtare. Në këtë grup bëjnë pjesë: dhënia e ryshfetit, ushtrimi i ndikimit, përdorimi i paautorizuar i pasurisë (shpërdorimi në detyrë). Në grupin e veprave penale jo të drejta hyjnë edhe veprat e përgjithshme penale, të cilat marrin formë të cilësuar, nëse ato i kryejnë personat zyrtarë; të tilla janë p.sh. shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës - neni 193, par. 4 i KPK; vendosja e skllavërisë, etj.
- Veprat penale të përgjithshme zyrtare janë veprat penale që mund të kryhen gjatë kryerjes së çdo detyre dhe kryes i tyre mund të jetë çdo person zyrtar, p.sh. shpërdorimi i pozitës ose i autorizimit zyrtar, marrja e ryshfetit.
- Veprat penale të posaçme zyrtare janë veprat penale që mund të kryhen vetëm në shërbime të caktuara dhe kryes të tyre mund të jenë vetëm personat e caktuar zyrtarë, p.sh., lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria, përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, që mund të kryhet jo nga çdo person zyrtar, po vetëm nga gjyqtari, gjyqtari laik apo gjyqtari për kundërvajtje.²⁸

Në bazë të nenit 414 të Kodit penal të Kosovës veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar e kryen personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

²⁸ Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1203

Kodi penal i Kosovës me ndryshimet e fundit në paragrafin e 2 të nenit 414 parasheh edhe dënim me gjobë dhe burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet nëse nga vepra penale e Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, e paraparë në nenin 414 në paragrafin 1 përfitohet apo shkaktohet dëm i cili tejkalon shumë prej pesmijë (5000) euro.

Për qëllime të këtij neni, shpërdorimi i detyrës zyrtare përfshinë, por nuk kufizohet në:

- shkeljen me dashje apo me dijeni të ligjit lidhur me detyrat apo punësimin e zyrtarit;
- moskryerja me dashje e ndonjë detyre të domosdoshme të përcaktuar me ligj;
- pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë së çfarëdo lloji si rezultat i kryerjes së detyrës zyrtare, përveç nëse pranimi i dhuratës, tarifës apo përparësisë lejohet me ligj;
- keqpërdorimi i pasurisë, shërbimeve apo personelit qeveritar apo i ndonjë sendit tjetër me vlerë që i përket qeverisë e që ka rënë në kujdesin apo posedimin e zyrtarit si rezultat i detyrës apo punës së tij; nënshtrimi me dashje i personit tjetër në keqtrajtim ose arrest, ndalim, kontroll, marrje, heqje, vlerësim ose barrë për të cilën e di se është e kundërligjshme; ose
- ndalimi ose pengimi me dashje i tjetrit në ushtrimin apo gëzimin e ndonjë të drejte, privilegji, pushteti apo imuniteti ligjor.²⁹

Analiza më e përafërt e veprave penale të këtij kapitull tregon se ato drejtohen në cënimin e vlerave të ndryshme të tilla janë: veprat penale të ushtrimit të pandërgjegjshëm të detyrave dhe veprat penale të keqpërdorimit të detyrave dhe autorizimeve zyrtare, veprat penale të korrupsionit, veprat penale lidhur me sekretin zyrtar, veprat penale lidhur me pasurinë zyrtare dhe veprat penale që mund t'i kryejë çdo person, të cilat janë klasifikuar këtu, ngase janë të lidhura në ndonjë mënyrë me veprat penale zyrtare (veprat penale të ushtrimit të ndikimit dhe veprat penale të dhënies së ryshfetit).³⁰

Një nga elementet themelore të përbashkëta të veprave penale të këtij kapitulli, është edhe ai që kryes i saj, në numrin më të madh të rasteve, mund të jetë vetëm personi zyrtar.

²⁹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr. 06/L-074, Gazeta Zyrtare E Republikës Së Kosovës , Nr.2, 14 Janar 2012, Prishtinë, neni 422.

³⁰ Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1205.

Kodi penal i Republikës së Kosovës njejt si edhe Kodi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut parasheh që këto vepra penale mund të kryhen vetëm me dashje. Kjo rezulton nga natyra e këtyre veprave penale, te të cilat më së shpeshti bëhet fjalë për veprimin e vullnetshëm dhe të pandërgjegjshëm gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, shpesh me qëllim të përfitimi të dobisë së caktuar. Mirpo përjashtim bën vepra penale e zbulimit të sekreteve zyrtare, për të cilën është parashikuar përgjegjësia penale edhe për pakujdesi.

Veprimi i kryerjes është përcaktuar në mënyrë alternative dhe vepra penale njejt paraqitet në tri forma, që janë: shfrytëzimi i pozitës zyrtare (shpërdorim) apo autorizimeve, tejkalimi i autorizimeve zyrtare dhe mospërbushja e detyrave zyrtare (moskryerja e detyrimeve zyrtare).

Korrupsioni paraqet një komponent negative të shtetit të Kosovës. Kosova rrënditet lartë për prezencë korrupsioni, konsiderohet vend shumë i korruptuar me përhapje të gjërë në institucione shtetërore. Bashkimi Evropian në mënyrë të vazhdueshme po i bën vërejtje për përmisim dhe ndërmarrje të masave kundër korrupsionit.

3.3 Vepra penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare sipas legjislacionit të Republikës së Kroacisë

Në Kodin Penal Kroat³¹ veprat penale kundër detyrës zyrtare janë të parapara në Kapitullin e XXVIII si “Veprat penale kundër detyrës zyrtare”. Ky kapitull në vete përfshin disa vepra penale dhe atë:

- Shpërdorimi i detyrës dhe autoritetit (neni 291);
- Favorizim i paligjshëm (neni 292);
- Marja i ryshfetit (neni 293);

³¹ Kodi Penal Kroat. <https://www.zakon.hr/z/98/Kazneni-zakon>

- Dhënia e ryshfetit (neni 294);
- Ndikimi në tregti (neni 295);
- Dhënia e ryshfetit për ndikim në tregëti (neni 296)
- Shfrytëzimi i dëshmisë (neni 297);
- Kërkimi i paligjshëm (neni 298);
- Lirimi i paligjshëm i një personi të privuar nga liria (neni 299);
- Zbulimi i një sekreti zyrtar (neni 300).

Edhe Kodi Penal Kroat veprat penale kundër detyrës zyrtare i ka sistemuar në një kapitull të veçant duke treguar rëndësinë që ky shtet ka në inkriminimin e këtyre veprave penale, parandalimin dhe dënimin e kryerësve të këtyre veprave penale.

Kroacia është një ndër shtetet që i jep një rëndësi të jashtëzakonshme luftimit të korrupsionit të zyrtarëve shtetëror dhe keqpërdorimit të pozitës zyrtare.

Vepra penale e keqpërdorimit të detyrës dhe autoritetit e paraparë në nenin 291 të Kodit Penal Kroat karakterizohet me përdorimin e kompetencave zyrtare për qëllime tjera dhe jo për qëllimet të cilat korrespondojnë me detyrat e shërbimit të dhënë.

Kjo vepër mund të kryhet vetëm nga persona zyrtarë ose persona përgjegjës që mund të përdorin pozitën ose autoritetin e tyre në mënyra të ndryshme, tejkalojnë kufijtë e autoritetit të tyre ose nuk kryejnë detyrën e tyre, duke përfituar kështu për vete apo një person tjetër ose duke i shkaktuar dëm dikujt tjetër.

Për formën themelore të veprës penale të Shpërdorimit të detyrës dhe autoritetit sipas Kodit Penal Kroat është paraparë dënimi me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vjet. Forma e kualifikuar e kësaj vepre penale do të kryhet nëse personi zyrtar ose përgjegjës, i cili në mënyrën e lartpërmendur fiton përfitim të konsiderueshëm të pasurisë ose shkakton dëme të konsiderueshme vlera e fitimit, dëmit të pasurisë tejkalon 60,000.00 HRK, në përputhje me nenin 87 paragrafi 29 të KPK-së³², për të cilën është paraparë dënimi me burg prej një deri në dhjetë vjet.

³² Kodi Penal Kroat, Neni 87, paragrafi 29.

Përfitimi sipas veprës penale të nenit 291 i KPK përfaqëson çdo përfitim pasuror ose jopasuror, siç janë gjërat që kanë një vlerë, shërbime dhe të ngjashme, dhe mund të merren për një person tjetër si për person fizik poashtu edhe për person juridik.

Korrupsioni dhe veprat penale të korrupsionit janë një temë aktuale dhe temë me interes për ekspertët kroat. Vepra penale e marrjes së ryshfetit është e paraparë në nenin 293 të Kodit Penal Kroat.

Sipas Kodit Penal Kroat përgjegjës është dhe dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet personi zyrtar ose personi përgjegjës i cili kërkon ose pranon ryshfet ose premtim apo ofertë për ryshfet për vete apo për dikë tjetër që në suaza të autorizimit të vet të kryejë veprimin zyrtarë të cilin do të duhej ta kryente, si dhe kërkesë së pranimit të dhuratës ose të ndonjë dobie tjetër pas kryerjes a moskryerjes së ndonjë pune zyrtare në lidhje me të.

Vepra penale e dhënies së ryshfetit ka të bëjë me dhënien, ofrimin ose premtimin e dhuratës personit zyrtar apo personit përgjegjës që i njejti të kryejë përkatsisht të mos kryejë ndonjë veprim zyrtar apo veprim tjetër brenda autorizimeve të cilat dalin nga pushteti i tij, si dhe ndërmjetsimin gjatë ryshfetit në cilëndo nga këto vepra. Ligji parasheh sanksione penale me heqje lirie deri në tetë vjet. Dhuratat dhe përfitimet materiale sekuestrohen. Paragrafi 3³³ i këtij neni parasheh lirimin nga dënimi për kryesin e veprës penale i cili ka dhënë ryshfet me kërkesë të personit përgjegjës apo zyrtar, mirpo të ketë raportuar veprën para se e njejta të zbulohet.

Kroacia ka aritur rezultate të mira në luftën kundër korrupsionit duke e luftuar në mënyrë aktive që nga pavarësia e saj.

E kushtëzuar nga kriteret e Bashkimit Evropian, Kroacia do të bëjë hapa serioz në luftën kundër korrupsionit duke krijuar organe të specializuara. Në këtë kontest Qeveria Kroate në vitin 2001 do të themelojë Zyrën për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (USKOK), pjesë e Zyrës së Prokurorit të Shtetit. Ajo dëshironte të krijonte një organ efektiv për veprim në të gjithë vendin në luftën kundër krimin të organizuar, monitorimit të incidencës së krimin të

³³ Kodi Penal Kroat, Neni 294, paragrafi 3.

organizuar dhe në bashkëpunim me organe të ngjashme nga vendet e tjera, bashkëpunim në luftimin e krimit të organizuar transnacional.

USKOK u krijua sepse rrjeti ekzistues i zyrave të avokatëve të shtetit dhe kompetenca e tyre për t'u marrë me raste të veprave penale të korruptuara dhe veprave penale në fushën e krimit të organizuar nuk ishte i duhuri. Rreziku i madh dhe efektet jashtëzakonisht të dëmshme të formave të tilla të krimit për shoqërinë në tërësi, kërkojnë një zgjidhje më efektive në formën e krijimit të një organi të specializuar, i cili përveç funksionit të tij shtypës, do të sigurojë edhe veprim parandalues.

Me krijimin e USKOK, Kroacia gjithashtu përmbushi detyrimet e marra nga ratifikimi i Konventës së Ligjit Penal për Korrupsionin dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të organizuar Transnacional, të cilat janë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kroacisë duke u bërë pjesë e rendit të brendshëm juridik Kroat.³⁴

Kroacia konsiderohet si shembull për rrugën drejt Bashkimit Evropian. Dënim i ish kryeministrit Ivo Sander i akuzuar për ryshfet , tregoi për seriozitetin e Kroacisë në çrrënjosjen e korrupsionit dhe keqpërdorimit të pushtetit si dhe pavarsinë e gjyqësorit nga ndikimi i politikës.

³⁴ <http://www.dorh.hr/Default.aspx?sec=18>

Kapitulli II-të

1. Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar

Këto shkelje të ligjit hyjnë në kuadër të kategorisë të veprave penale kundër detyrës zyrtare, të përfshira brenda kapitullit XXX.

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut numëron disa vepra në kuadër të veprave penale kundër detyrës zyrtare dhe atë³⁵:

- Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar - Neni 353
- Shkelja e ruajtjes së kufirit shtetëror - Neni 353-a
- Moszbatimi i urdhërit - Neni 353-b
- Të punuarit e pandërgjegjshëm gjatë detyrës - Neni 353-c
- Shpërdorimi i shërbimit - Neni 354
- Mashtrimi gjatë shërbimit - Neni 355
- Të shërbyerit gjatë detyrës - Neni 356
- Marrja e ryshfetit - Neni 357
- Dhënia e ryshfetit - Neni 358
- Ndërmjetsimi i kundërligjshëm - Neni 359
- Fitimi i kundërligjshëm dhe pasuria e fshehur - Neni 359-a
- Zbulimi i fshehtësisë zyrtare - Neni 360
- Keqpërdorimi i fshehtësisë shtetërore, zyrtare apo ushtarake - Neni 360-a
- Falsifikimi i dokumenteve zyrtare - Neni 361
- Arkëtimi dhe pagesa kundërligjore - Neni 362

Në këtë punim në mënyrë më të detajuar do të shtjellohen disa nga këto vepra penale.

³⁵ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta zyrtare e RM-së" nr.28, datë 06.02.2014.

Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar është rregulluar me nenin 353 të Kodit Penal. Kryerës i kësaj vepre penale duhet të ketë cilësi të personit zyrtar apo personit përgjegjës.

Keqpërdorimi i detyrës zyrtare është një vepër e ndërmarë gjatë ushtrimit të detyrës por, jo në interes së detyrës, por në interes individual të kundërligjshëm. Forma më e rëndë e kësaj vepre penale është paraparë nëse vepra kryhet gjatë realizimit të furnizimeve publike apo në dëm të mjeteve të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, nga fondet publike apo nga mjetet tjera të shtetit.

Kryerës i kësaj vepre penale duhet të ketë cilësi të personit zyrtar apo personit përgjegjës. Këtë vepër penale e kryen personi zyrtar i cili me shfrytëzimin e pozitës apo të autorizimit të vetë zyrtar, me tejkalimin e kufijve të autorizimit të vetë zyrtar apo me mos zbatimin e detyrës së vetë zyrtare do të përfitojë, do të fitojë për vete apo për tjetërkënd ndonjë dobi ose tjetërkujt do ti shkaktojë dëm.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në:

- a) shfrytëzimin (keqpërdorimin) e pozitës zyrtare;
- b) tejkalimin e autorizimeve të veta;
- c) mos kryerja e detyrave zyrtare.³⁶

Shfrytëzimi i detyrës zyrtare apo i autorizimeve ekziston kur personi zyrtar ndërmerr veprime të cilat formalisht janë në kuadër të autorizimeve të tij, por janë të kundërligjshme në aspektin material, ngase janë në kundërshtim me interesat dhe detyrat e shërbimit. Me veprimin e tij kryerësi i lë pas dore interesat dhe qëllimet e shërbimit dhe ato i zëvendëson me interesat e veta ose interesat e ndonjë personi tjetër. Ai detyrën dhe autorizimin e tij i shfrytëzon për t'i sjellë vetes apo tjetrit çfarëdo dobie ose për t'i shkaktuar tjetrit dëm.³⁷

Tejkalimi i autorizimeve zyrtare ekziston kur personi zyrtar vepron jashtë autorizimeve zyrtare dhe jashtë kompetencave të tij reale. Kryerësi i veprës penale tejkalon kufijtë e autorizimeve të veta zyrtare, ngase ndërmerr veprime zyrtare që cilat janë në kompetencë të një personi tjetër zyrtar (të një instance më të lart; a më të ulët), ose që i përket një shërbimi krejtësisht tjetër

³⁶ Zejneli, Ismail, E Drejta Penale-Pjesa e posaçme, Tetovë, 2007, fq. 151.

³⁷ I. Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1209.

(i ashtuquajtur i uzurpim). Vepra ekziston edhe kur personi zyrtar vepron pa pëlqimin dhe pa lejen paraprake të personit tjetër, e cila në rastin konkret është e domosdoshme. Për ekzistimin e kësaj forme të keqpërdorimit është e domosdoshme të vërtetohen kufijtë e autorizimit të personit zyrtar, në bazë të dispozitave që kanë të bëjnë me këtë shërbim. P.sh., zyrtari i punëve të brendshme ka falsifikuar autorizimin për kontrollimin e banesës dhe në bazë të këtij autorizimi, ka kryer kontrollin bastisjen e banesës; ose personi zyrtar ka plotësuar fletëpagesën për vete, ndonëse atë është dashur ta plotësojë një person tjetër dhe në bazë të kësaj, ka përfituar pagesën për punë jashtë orarit të punës, etj.³⁸

Moskryerja e detyrës zyrtare ekziston kur personi zyrtar nuk e kryen detyrën zyrtare, nuk ndërmerr veprimin zyrtar që është i detyruar ta ndërmarrë, ose kur këtë veprim e bën të tillë që të mos mund të arrihet qëllimi, i cili do të realizohej, po ta ndërmernte atë veprim (kryerja formale ose lëshimi material i detyrës zyrtare); personi zyrtar nuk e bën atë që u përket kompetencave të tij e që është i detyruar ta bëjë; ai refuzon ta kryejë atë që është i detyruar ta kryejë, ose zvarrit ndërmarrjen a kryerjen e ndonjë detyrimi të tij zyrtar.

Do të kishim të bënim me raste të tilla, p.sh., kur personi zyrtar s’e nxjerrë fare aktin, të cilin është i detyruar ta nxjerrë; kur refuzon të vendosë për ndonjë çështje që i përket kompetencës së tij; kur qytetarit nuk do t’ia japë certifikatën që e kërkon personi i interesuar etj.. Në raste të tilla personi zyrtar nuk e kryen detyrën e tij as në kuptimin formal, as në kuptimin material. Vepra penale ekziston edhe kur personi zyrtar formalisht e kryen detyrën zyrtare, ndërmerr veprimin zyrtar, por për shkak të mënyrës dhe kohës kur ndërmerret, ajo nuk mund të prodhojë efektet e pritura; në këtë situatë ekziston moskryerja materiale e detyrës zyrtare, p.sh., personi zyrtar nxjer me vonesë të madhe aktin e pritur zyrtar, i cili më nuk mund të prodhojë efekt juridik.³⁹

Kryes i kësaj vepre penale mund të jetë personi zyrtar. Nocioni i personit zyrtar është i përcaktuar në nenin 122 paragrafi 4.

³⁸ I. Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1210.

³⁹ Po aty, faqe 1210.

Si person zyrtar⁴⁰, kur ky është caktuar si kryerës i veprës penale llogaritet:

- a) kryetari i Republikës së Maqedonisë, ambasadorët dhe përfaqësuesit tjerë të vënë të Republikës së Maqedonisë në botën e jashtme dhe persona të emëruar nga kryetari i Republikës së Maqedonisë, funksionar i zgjedhur ose i emëruar në dhe nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, në organet e administratës shtetërore, në gjykatat, prokurorinë publike, Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, Këshillin e prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë dhe organe dhe organizata tjera që kryejnë punë të caktuara profesionale, administrative dhe punë të tjera në kornizat e të drejtave dhe detyrimeve të Republikës, në njësitë e vetadministrimit lokal si dhe persona që në mënyrë permanente apo të përkohëshme kryejnë detyra zyrtare në këto organe apo organizata;
- b) nënpunësi shtetëror që kryen punë profesionale, normative-juridike, ekzekutive, administativo-mbikëqyrëse dhe punë administrative në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin;
- c) personi i autorizuar në personin juridik të cilit me ligj ose me dispozitë tjetër të marrë në bazë të ligjit i është besuar ushtrimi i autorizimeve publike, kur detyrën e ushtron në suaza të këtyre autorizimeve;
- c) personi i cili ushtron detyra të caktuara zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj apo me dispozita të tjera të miratuara në bazë të ligjit;
- d) personi ushtarak kur janë në pyetje veprat penale të cilat si kryerës është caktuar personi zyrtar dhe
- dh) përfaqësuesi i shtetit të huaj ose i organizatës ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë.

Lidhur me fajësinë, kjo vepër penale mund të kryhet me dashje e cila duhet të përfshijë edhe vetëdijen e kryerësit të veprës penale se dëshiron të keqpërdorë pozitën zyrtare duke i tejkaluar kufijtë e autorizimeve të veta.

Për këtë formë të veprës penale në bazë të nenit 1 të Kodit Penal është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

Forma më e rëndë e kësaj vepre penale është paraparë në nenet 2 dhe 3 dhe konsiderohet se është kryer nëse kryerësi i veprës nga paragrafi 1 do të përfitojë dobi më të madhe të pasurisë

⁴⁰ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta zyrtare e RM-së" nr.28, datë 06.02.2014, Neni 122, parag. 4.

apo do të shkaktojë dëm më të madh të pasurisë apo më rëndë do t'i shkelë të drejtat tjetërkujt, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet, ndërkaq nëse kryerësi i veprës nga paragrafi 1 përfiton dobi të konsiderueshme të pasurisë apo shkakton dëm të konsiderueshëm, kryerësi do të dënohet me së paku tre vjet burgim.

Përgjegjës është dhe dënohet edhe personi përgjegjës, personi përgjegjës në personin e huaj juridik që ka përfaqësi apo kryen veprimtari në Republikën e Maqedonisë apo personi që kryen punë me karakter publik, nëse vepra është e kryer gjatë kryerjes së autorizimit apo detyrës së tij të posaçme.

Në nenin 122 paragrafi 6 është përcaktuar nocioni për personit juridik, që nënkuptohet: Republika e Maqedonisë, njesitë e vetëqeverisjes vendore, partitë politike, ndërmarrjet publike, shoqatat tregtare, institucionet dhe asociacionet e tjera, fondet, organizatat financiare dhe organizatat tjera të caktuara me ligj të regjistruar si persona juridikë dhe bashkësitë dhe organizatat e tjera të cilave u njohet cilësia e personave juridikë.

Si person i huaj juridik nënkuptohet ndërmarrja publike, institucioni, fondi, banka, shoqata tregtare ose forma tjera të organizimit sipas ligjit të shtetit të huaj për të kryer veprimtari ekonomike, financiare, bankare, tregtare, shërbyese apo veprimtari tjera, që ka seli në shtet tjetër apo përfaqsi në Republikën e Maqedonisë, apo është e themeluar si shoqatë, fond, bankë apo institucion ndërkombëtar.⁴¹

Nëse vepra nga paragrafët 1 dhe 4 është kryer gjatë kryerjes së furnizimeve publike apo në dëm të mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, nga fondet publike apo nga mjetet tjera të shtetit, kryerësi do të dënohet me së paku pesë vjet burgim

⁴¹ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta zyrtare e RM-së" nr.28, datë 06.02.2014, Neni 122, parag. 6.

2. Të punuarit e pandërgjegjshëm gjatë detyrës

Forma themelore e kësaj veprë dhe gjithë elementet e saj duke përfshirë edhe ekzekutimin, janë paraparë në paragrafin 1 të këtij neni (353-c). Kjo vepër paraqitet në rastet kur personi zyrtar apo personi përgjegjës në ndërmarrje apo në institucion publik i cili me shkelje të rregullave ligjore për konflikt të interesave apo për veprim të vetëdijshëm gjatë kryerjes së autorizimit diskrecional, me lëshim të mbikëqyrjes së detyruar apo në mënyrë tjetër dukshëm vepron pandërgjegjshëm gjatë kryerjes së autorizimeve dhe detyrave të veta dhe me të do të përfitojë për vete apo për tjetër kënd ndonjë dobi apo tjetrit do t'i shkaktojë dëm.

Për formën e tillë të veprës penale është paraparë dënim me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

Rrethana rrënduese gjatë kryerjes së kësaj veprë penale paraqitet në rast se kryerësi i kësaj veprë penale përfiton dobi më të madhe të pasurisë apo shkakton dëm të madh të pasurisë apo më rëndë i shkel të drejtat e tjetrit, me çka do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Paragrafi 3 i këtij neni parasheh edhe rastet kur nga vepra e tillë penale përfitohet një dobi e konsiderueshme e pasurisë apo shkaktimin e dëmit të konsiderueshëm, dhe për veprën e tillë parasheh dënim me së paku tre vjet burgim.

Përgjeggjës janë dhe dënohen me të njejtat dënime edhe personi përgjegjës, personi përgjegjës në personin e huaj juridik i cili ka përfaqësi në Republikën e Maqedonisë apo personi i cili kryen punë me karakter publik, nëse vepra është kryer gjatë autorizimit apo detyrës së posaçme të tij të përcaktuar me ligj.

Personi zyrtar apo personi përgjegjës në organet e administratës shtetërore apo në subjekt tjetër juridik i cili me shkelje të rregullave ligjore për zhvillimin e procedurave administrative, me lëshim të mbikëqyrjes së detyruar apo në mënyrë tjetër vepron gjatë kryerjes së autorizimeve dhe detyrave të veta dhe me këtë do të përfitojë për vete apo për tjetër kënd ndonjë dobi apo tjetrit do t'i shkaktojë dëm, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri

tre vjet dhe dënim me gjobë. Nëse kjo vepër është kryer nga pakujdesia, kryerësi do të dënohet me dënim me burg deri në dy vjet dhe dënim me gjobë.

3. Keqpërdorimi i shërbimit

Sipas paragrafit 1 të nenit 354 këtë vepër penale e kryen personi zyrtar i cili me qëllim që të përfitojë për vete ose për tjetërkënd dobi të kundërligjshme të pasurisë do të përvetësojë para, letra me vlerë apo sende të tjera të luajtëshme të besuara në shërbim, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.⁴²

Veprimi i kryerjes së kësaj veprë penale konsiston në përfitimin e parave, letrave me vlerë apo sendeve tjera të luajtëshme me qëllim të përfitimit në mënyrë të kundërligjshme. Për të konsideruar se ekziston kjo vepër penale nevojitet që këto sende t'i jenë besuar kryerësit në shërbim (në ruajtje, materiali i zyrës, mjetet teknike, para në arkë) si dhe të gjendet në pronësi të kryerësit në momentin e kryerjes së veprës.

Kryerës i kësaj veprë penale mund të jetë personi zyrtar në punë.

Lidhur me fajësinë, kjo vepër penale mund të kryhet me dashje e cila duhet të përfshijë edhe vetëdijen e kryerësit të veprës penale se dëshiron të përvetësojë pasuri të kundërligjshme .

Forma më e rëndë e kësaj veprë penale është paraparë në paragrafin 2 dhe konsiderohet se është kryer nëse kryerësi i veprës ka përfituar dobi të madhe të pasurisë. Për këtë formë të veprës penale është paraparë dënimi me burgim prej 1 deri në 10 vite.

Paragrafi 3 parasheh dënim me së paku katër vjet nëse nga kryerja e kësaj veprë është fituar dobi të konsiderueshme të pasurisë.

Në paragrafin e 4 të këtij neni parashihet rastet kur kryerësi i kësaj veprë penale nga paragrafi 1 ka përfituar dobi të vogël pasurie dhe ka shkuar nga ajo që të përfitojë dobi të atillë të pasurisë, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet.

⁴² Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta zyrtare e RM-së" nr.28, datë 06.02.2014.

Kodi penal në nenin 122 në paragrafin 33 përcakton kuptimin e dobisë së vogël pasurore: “Me dobi, vlerë apo dëm i vogël pasuror, nënkuptohet dobia, vlera apo dëmi që i përgjigjet shumës së një gjysmë rroge mesatare mujore e shpallur zyrtarisht në Republikën e Maqedonisë në kohën e kryerjes së veprës”.

Për këtë vepër penale dënohet edhe personi përgjegjës, personi përgjegjës në personin e huaj juridik që ka përfaqësi në Republikën e Maqedonisë apo personi i cili kryen punë me karakter publik, nëse vepra është kryer gjatë kryerjes së autorizimit apo detyrës së tij të posaçme të caktuar me ligj.

4. Marrja e ryshfetit

Për një shoqëri demokratike të organizuar nuk ka gjë më të rrezikshme se marrja e ryshfetit nga ana e bartësve të funksioneve të shërbimeve publike. Kjo vepër penale, si dhe akti i ryshfetit, janë veprat kryesore të korrupsionit. Korrupsioni është një ndër format më të rënda të një dukurie të përhapur në shoqëritë moderne dhe fatkeqësisht disa forma të korrupsionit janë bërë përditshmëri brengosëse në vend. Korrupsioni është kthyer në një rrezik serioz për shoqërinë i cili përbën një rrezik për konsolidimin e një shteti ligjor dhe demokratik. Kjo rrezikshmëri shoqërore është edhe shkaku që jo rrallë herë korrupsioni dhe lufta kundër tij në botë trajtohen në një rrafsh me luftën kundër krimit të organizuar duke e konsideruar si një nga përbërësit kryesor të tij.⁴³

Sipas ligjit për parandalimin të korrupsionit dhe konfliktit të interesave me korrupsion nënkuptojmë keqpërdorimin e funksionit, autorizimit publik, detyrës zyrtare apo pozitës për të përfituar ndonjë dobi, drejtpërdrejt apo përmes një nërmjetsuesi për vete apo për dikë tjetër.

Në bazë të këtij ligji, termi korrupsion përfshin edhe atë që quhet korrupsion pasiv. Në shumicën e rasteve marrja e ryshfetit identifikohet me korrupsionin pasiv.

⁴³ Zejneli, Ismail, E Drejta Penale-Pjesa e posaçme, Tetovë, 2007, fq. 153.

Korrupsioni pasiv paraqet veprim të qëllimshëm të një zyrtari, i cili drejtpërdrejt ose përmes një ndërmjetësuesi kërkon ose merr një përfitim të çfarëdo lloji, për vete apo për një palë të tretë, ose pranon një premtim për një përfitim të tillë, me qëllim që të veprojë ose të përmbahet nga veprimi në pajtim me detyrimet e tij ose kryerjen e detyrave të tij në kundërshtim me detyrat zyrtare.⁴⁴

Korrupsioni si vepër penale është paraparë edhe me akte ndërkombëtare, ndër të cilat është edhe Konventa Penale për Korrupsion. Konventa parasheh edhe korrupsionin pasiv të zyrtarëve publikë kombëtarë.

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale, sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim kërkimin ose marrjen nga cilido prej zyrtarëve publikë të asaj Pale, direkt ose indirekt, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon, për vete ose për të tjerë, ose pranimi i një oferte ose premtimi apo avantazhi të tillë, për të vepruar ose mosvepruar në ushtrim të funksioneve të tij/saj.⁴⁵

Marrja e një ryshfeti (neni 357 i KPMV-së) - kjo vepër penale, si dhe akti i ryshfetit, janë veprat kryesore të korrupsionit. Vepra kryesore është i ashtuquajturi ryshfeti i drejtë pasiv i përbërë nga kërkesa direkte ose indirekte, ose marrja e një dhurate ose përfitimi tjetër për kryerësin për të kryer një veprim zyrtar të cilin ai nuk lejohet të kryejë, ose të mos kryejë një veprim që do të duhej të kryente, të gjitha këto brenda fushëveprimit të kompetencave të tij zyrtare. Iniciativa vjen nga personi zyrtar dhe personi që e pranon atë do të jetë përgjegjës për aktin dhënie e ryshfetit.

Ryshfeti pasiv jo i drejtë përmban gjithashtu edhe kërkesën direkte ose indirekte ose marrjen e një dhurate ose përfitim tjetër, por këtë herë kryerësi duhet të kryejë një veprim zyrtar që ai duhet të kryejë ose të mos kryejë një veprim që nuk duhet të kryhet në kuadër të kompetencave të tij zyrtare. Për shembull, personi ju kërkon një "ryshfet" për t'ju dhënë një diplomë ose certifikatë që gjithësesi duhet të merrni!

⁴⁴ Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Gazeta zyrtare e RMV-së janar 2019, nr. 12, neni 2, paragrafi 2.

⁴⁵ Konventa Penale për Korrupsion, Strasburg 1999, neni 3.

Një ryshfet shtesë pasiv është një formë e veçantë e ryshfetit të drejtë ose të jo-drejtë pasiv që përbëhet nga veprimi sipas kërkesës ose marrjes së një dhurate, përfitim pas kryerjes së veprimtarisë ose jo kryerja e veprimeve zyrtare në varësi të formës.

Në paragrafin 1 të nenit 357 të Kodit penal përgjegjësi penale dhe dënim me së paku katër vjet burgim ka personi zyrtar i cili drejtpërdrejtë apo tërthorazi do të kërkojë apo do të pranojë dhuratë apo dobi tjetër ose do të pranojë premtim për dhuratë apo dobi tjetër për vete apo për tjetërkënd që në suaza të autorizimit të vet zyrtar të kryejë ndonjë veprim zyrtar që nuk do të guxonte ta kryejë apo të mos e kryejë veprimin zyrtar që duhet ta kryejë. Përkatësisht sipas paragrafit 2 do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet që në suaza të autorizimit të vet zyrtar të kryejë ndonjë veprim zyrtar që duhet të kryejë apo të mos kryejë veprim zyrtar që nuk guxon ta kryejë.

Forma më e lehtë është e paraparë në paragrafin e 3 ku është paraparë përgjegjësia penale për personin zyrtar i cili pas kryerjes apo moskryerjes të veprimeve zyrtare të parapara në paragrafët 1 dhe 2 lidhur me atë do të kërkojë apo do të pranojë dhuratë apo dobi tjetër, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.

4) Nëse me veprën është fituar dobi më e madhe pasurore, kryerësi do të dënohet me së paku katër vjet burgim.

5) Nëse me veprën është fituar dobi e konsiderueshme pasurore, kryerësi do të dënohet me së paku pesë vjet burgim.

6) Me dënim nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës i cili kryen punë me karakter publik, personi përgjegjës në personin e huaj juridik, si dhe personi i i huaj zyrtar nëse vepra është kryer me shkeljen e autorizimeve të tij, lidhur me fitimin, realizimin apo marrjen e të drejtave të caktuara me ligj apo për shkak të fitimit të dobisë apo shkaktimit të dëmit tjetërkujt.

7) Dhurata apo dobia pasurore e pranuar do të merret.

Kryerësi i kësaj vepre penale mund të jetë personi zyrtar dhe personi përgjegjës. Kryerësi i kësaj vepre është përgjegjës dhe dënohet nëse drejtpërdrejtë apo tërthorazi do të kërkojë apo do të pranojë dhuratë apo dobi tjetër ose do të pranojë premtim për dhuratë apo dobi tjetër për vete apo për tjetërkënd.

Kjo vepër penale konsiderohet se është e kryer me vetëm kërkimin e ryshfetit apo me marrjen e ryshfetit apo premtimin për të. Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në :

- a) duke kërkuar dhuratë apo përfitim tjetër;
- b) duke pranuar dhuratë apo përfitim tjetër;
- c) duke pranuar premtim për ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër;⁴⁶

Te përshkrimi i veprës penale ndeshim shprehjen “dhuratë apo përfitim tjetër “. Dhuratë është çdo send i prekshëm dhe i paprekshëm. Sende mund të jenë sendet e tashme dhe të ardhshme (p.sh. frutat). Tek sendet e paprekshme hyjnë vetëm të drejtat. E rëndësishme është bartja e asaj të drejte.⁴⁷

Me nocionin përfitim nënkuptojmë arritjen e çfardo përfitimi material ose jomaterial, komoditeti ose avantazhi për veten ose për një tjetër.⁴⁸ Përfitimi tjetër përfshin çdo përfitim që nuk bën pjesë në kuadër të shprehjes dhuratë, nuk është e thënë që ai të jetë çdo herë diçka materiale. Ai mund të jetë, p.sh., një vend më i mirë i punës, marrja e kredisë a bursës etj.; shkurt, aty hyjnë të gjitha llojet e përparësive dhe favoreve reale të marrësit të ryshfetit apo të një personi tjetër në shkëmbim të “punës së kryer”.⁴⁹

Lidhur me fajsinë, kjo vepër penale mund të kryhet me dashje e cila duhet të përfshijë edhe vetëdijen e kryerësit të veprës penale se është duke marrë dhurata apo përfitime tjera.

⁴⁶ Zejneli, Ismail, E Drejta Penale-Pjesa e posaçme, Tetovë 2007, fq. 153.

⁴⁷ I. Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1244.

⁴⁸ Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Gazeta zyrtare e RMV-së janar 2019, nr. 12, neni 8, paragrafi 5.

⁴⁹ I. Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1244.

5. Dhënia e rryshfetit

Dhënia e rryshfetit quhet edhe rryshfet aktiv. Është në thelb një akt që nxiton apo drejton zyrtarin në një procedurë që është e paligjshme.

Rryshfeti i drejtë aktiv përfshin veprim të përbërë nga dhënia ose premtimi i një dhurate apo tjetër përfitim ose ndërmjetësim gjatë dhënies së rryshfetit aktiv në mënyrë që zyrtari mos të kryejë një veprim që do të duhet të ekzekutojë ose të kryejë një veprim që nuk duhet të kryhet. Akti përfundon me dhënien ose ofrimin e një dhurate, përfitimi, etj. pa dallim nëse zyrtari e ka pranuar atë apo jo.

Rryshfeti jo i drejtë aktiv është dhënia ose premtimi i një dhurate apo përfitimit tjetër për personin zyrtar në përputhje me kompetencat dhe detyrat e tij.⁵⁰

Dhënia e rryshfetit si vepër penale është e paraparë në nenin 358 të Kodit Penal të RMV-së. Sipas parag. 1 të këtij neni këtë vepër penale e kryen ai i cili drejtpërdrejtë apo tërthorazi personit zyrtar do t'i japë apo do t'i ofrojë dhuratë apo dobi tjetër për atë ose për tjetërkënd që në suaza të autorizimit të vet zyrtar të kryejë veprim zyrtar që nuk guxon ta kryejë ose të mos kryejë veprim zyrtar që është dashur ta kryejë apo ai i cili ndërmjetson në këtë, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet.

Përkatsisht sipas paragrafit 2 do të dënohet me dënim më gjorbë ose me burgim deri tre vjet nëse kërkon nga personi zyrtar që në suaza të autorizimit të vet zyrtar të kryejë veprim zyrtar që duhet ta kryejë apo të mos kryejë veprim zyrtar që nuk guxon ta kryejë apo ai i cili ndërmjetëson në këtë.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në:

- a) dhënien e dhuratës apo të përfitimit tjetër personit zyrtar
- b) premtimin e ndonjë dhurate apo përfitimi tjetër;
- c) ndërmjetësimin e dhënies së rryshfetit personit zyrtar.⁵¹

⁵⁰ Doracak Për Aplikimin E Ligjit Për Mbrojtjen E Denoncuesve Në Arsimin E Lartë Në Republikën E Maqedonisë, Shkup, Prill 2018, fq.13.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, nuk është e domosdoshme të ketë ndonjë cilësi të veçantë.⁵²

Kjo vepër penale konsiderohet se është kryer me vetë faktin e premtimit apo dhënies së dhuratës dhe nuk është e domosdoshme që personi zyrtar ta kishte kryer apo mos e kishte kryer veprimin e kundërligjshëm.

Lidhur me fajësinë, kjo vepër penale mund të kryhet me dashje e cila duhet të përfshijë edhe vetëdijen e kryerësit të veprës penale se me dhënien e ryshfetit nga personi zyrtar kërkohet që të kryejë apo të mos kryejë veprime zyrtare.

Me qëllim të nxitjes së zbulimit të shkeljeve të korrupsionit, ligji gjithashtu parashikon një bazë fakultative për përjashtim nga dënimi në rast të denoncimit të aktit të ryshfetit aktiv përpara se të zbulohet nëse është kryer me kërkesë të zyrtarit.⁵³

Me paragrafin 3 të po të këtij neni kryerësi i veprës i cili ka dhënë apo ka premtuar rryshfet me kërkesën e personit zyrtar e që e paraqet para se të dijë se vepra është zbuluar lirohet nga dënimi.

4) Dispozitat nga paragrafët 1,2 dhe 3 zbatohen edhe kur ryshfeti i është dhënë apo premtuar personit përgjegjës, personit përgjegjës në personin e huaj juridik, personit i cili kryen punë me karakter publik dhe personit të huaj zyrtar lidhur me veprën nga neni 357.

5) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet edhe me gjobë.

Për veprën penale dhënie e ryshfetit janë përgjegjës të gjithë personat juridik, me përjashtim të shtetit; personat juridik të huaj janë përgjegjës nëse veprën e kanë kryer në territorin e RMV-së, pa marrë parasysh se a kanë përfaqësi apo filiale të veten që ushtron veprimtari në territorin e saj.

⁵¹ Zejneli, Ismail, E Drejta Penale-Pjesa e posaçme, Tetovë 2007, fq. 154.

⁵² Grup autorësh, Kriminaliteti i organizuar-aspekte juridike, Tetovë, 2009, fq.193.

⁵³ Doracak Për Aplikimin E Ligjit Për Mbrojtjen E Denoncuesve Në Arsimin E Lartë Në Republikën E Maqedonisë, Shkup, Prill 2018, fq.13.

Në paragrafin 6 është paraparë se dhurata dhe përfitimi tjetër do të konfiskohen ose do të merren dhe do ti kthehen dhënësit të ryshfetit, nëse dhurata është kërkuar nga personi zyrtar dhe nëse e njejta është paraqitur para se të zbulohet vepra.

Nëse me veprën penale të kryerësit është përfituar dobi pasurore për personin juridik, dobia do të konfiskohet nga ai.⁵⁴ Nëse nga personi juridik nuk mund të konfiskohet pasuria apo dobia pasurore për shkak se ka pushuar së ekzistuari para realizimit të konfiskimit atëher duke u nisur nga parimi ai që e fiton dobinë nga puna e personit juridik (themeluesi, aksionarët dhe bashkthemeluesit) duhet solidarisht ta paguajnë gjithë dobinë e kundërligjshme pasurore të përfituar me vepër penale.

Korrupsioni aktiv i zyrtarëve publikë kombëtarë parasheh që secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale, sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim premtimin, ofrimin ose dhënien direkt ose indirekt të çfarëdo lloj avantazhi, që nuk i takon cilit do zyrtari publik të asaj Pale, për vete ose për dikë tjetër, ndaj tij/saj, për të vepruar ose mosvepruar në ushtrim të funksioneve të tij/saj.⁵⁵

⁵⁴ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e RM-së” nr.28, datë 06.02.2014, Neni 100.

⁵⁵ Konventa Penale për Korrupsion, Strasburg 1999, neni 2.

6. Fitimi i kundërligjshëm dhe pasuria e fshehur

Në Kodin penal të RMV-së është inkriminuar vepra penale e fitimit të kundërligjshëm dhe pasuria e fshehur. Ky inkriminim mbështetet në Ligjin për parandalimin e korrupsionit i cili përcakton detyrimin e nëpunësve zyrtarë që të deklarojnë gjendjen pronësore të tyre dhe të gjitha rritjet e konsiderueshme të pasurisë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.

Në ligj janë përcaktuar personat të cilët mbartin detyrimin për deklarim.

Deklarimi përmban; sendet e luajtëshme në mënyrë të detajuar, sendet e luajtëshme vlera e të cilave e tejkalon shumën e 20 pagave mesatare neto në tremujorin e kaluar, letra me vlerë, borxhet, si dhe pronë tjetër që është në pronësi të tij ose në pronësi të anëtarëve të familjes së tij duke theksuar bazën e përvetësimit të pasurisë së deklaruar; deklaratë interesi për të dhe anëtarët e tij të familjes, i cili përmban informacione për vendet e punës dhe anëtarësimin në bordet e drejtorëve, anëtarësimin në shoqata dhe fondacionet dhe të dhënat e tjera të kërkuara në përputhje me formularin e përcaktuar.⁵⁶

Sipas pragrafit 1 të Nenit 359-a të Kodit Penal të RMV-së vepra penale Fitim i kundërligjshëm dhe pasuria e fshehur e definohet si : Personi zyrtar dhe personi përgjegjës në ndërmarrje publike, institucion publik apo në person tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, i cili në kundërshtim me detyrën ligjore për paraqitjen e gjendjes së pasurisë apo ndyshimit të saj, do të jep të dhëna të rrejshme apo jo të plota për pasurinë e vet apo pasurinë e anëtarëve të familjes së vet, e cila në vlerë të konsiderueshme i tejkalon të hyrat e tij ligjore do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet dhe me dënim me gjobë.

Forma e parë e kësaj vepre penale përbëhet në dhënien e të dhënave të rrejshme për të ardhurat personale, ndërkaq forma e dytë ka të bëjë me fshehjen e burimeve të vërteta.

Me dënimin nga paragrafi 1 të këtij neni do të dënohet personi zyrtar apo personi përgjegjës në ndërmarrje publike, institucion publik apo në person tjetër juridik që disponon me kapital

⁵⁶ Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Gazeta zyrtare e RMV-së janar 2019, nr. 12, neni 88, paragrafi 2

shtetëror, i cili kur në procedurë të rregulluar ligjore do të vërtetohet se gjatë kryerjes së funksionit apo detyrës ai apo antar të familjes së tij ka fituar pasuri që në vlerë të konsiderueshme i tejkalon të hyrat e tij ligjore, jep të dhëna të rrejshme apo i mbulon burimet e tij të vërteta.⁵⁷

Nëse kjo veprë penale është kryer lidhur me pasurinë që në përmasa të mëdha i tejkalon të hyrat e tij ligjore, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri tetë vjet dhe me dënim me gjobë.

Kryerësi nuk do të dënohet nëse në procedurë para gjyqit jep sqarim të pranueshëm për origjinën e pasurisë së tij.⁵⁸ Mirëpo në rast se pasuria e cila i tejkalon të hyrat që kryerësi në mënyrë ligjore i ka realizuar dhe për të cilat ka dhënë të dhëna të rrejshme apo jo të plota apo nuk jep të dhëna apo i mbulon burimet e tij të vërteta, konfiskohet.

Nga kryerësi do të konfiskohet dobia e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë pasurore e fituar me veprën penale që përbëhet nga paratë, sendet me vlerë të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo pronë tjetër, pasuri apo aktive, të drejta materiale apo jomateriale e nëse konfiskimi i tyre nuk është i mundshëm, nga kryerësi do t'i konfiskohen pasuri tjetër që i përgjigjet vlerës së dobisë si fituar.⁵⁹ Në këtë rast vjen në shprehje konfiskimi në vlerë, pasi ekzistojnë raste kur kryerësi i veprës penale produktet e fituara nga vepra penale mund të mos i posedojë më në momentin e shqiptimit të masës.

Konfiskimi i pronës dhe dobisë pasurore është përkufizuar si masë e veçantë juridiko-penale me shqiptimin e së cilës sekuestrohet me detyrim dobia pasurore e drejtpëdrejt ose e tërthortë e fituar me veprën penale.

Kjo masë nuk është e drejtuar ekskluzivisht vetëm ndaj kryerësit të veprës penale por edhe ndaj personave të tretë, personave të cilëve i pandehuri në mënyrë formale ua ka bartur pasurinë e tij kriminale për t'iu shmangur konfiskimit.

⁵⁷ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta zyrtare e RM-së" nr.28, datë 06.02.2014, neni 359-a, paragrafi 2.

⁵⁸ Po aty, neni 359-a, paragrafi 4.

⁵⁹ Po aty, neni 98, paragrafi 1.

Askush nuk mund të mbajë dobinë e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të pasurisë së përfituar me vepër penale.⁶⁰

Paragrafi 6 parasheh konfiskimin e pasurisë edhe nga antarët e familje së kryerësit për të cilët është realizuar apo mbi të cilët është bartë, nëse është e dukshme se nuk kanë dhënë kundërkompensim që i përgjigjet vlerës së saj, si dhe nga personat e tretë nëse nuk dëshmojnë se për sendin apo për pasurinë kanë dhënë kundërkompensim që i përgjigjet vlerës së saj.

7. Falsifikimi i dokumenteve zyrtare

Kjo vepër penale është një lloj i falsifikimit intelektual. Nisur nga fakti se falsifikimi i dokumenteve zyrtare shërben kryesisht për kryerjen ose për fshehjen e ndonjë veprë tjetër penale, kjo vepër penale shpesh kryhet në bashkim me vepra të tilla, si, p.sh., me veprën e marrjes së ryshfetit, të shpërdorimit, mashtrimit në detyrë, etj.⁶¹

Kjo vepër konsiderohet se është kryer në qoftë se personi zyrtar në dokumentin, librin apo shkresën zyrtare do të shënojë të dhëna të pavërteta apo nuk do të shënojë ndonjë të dhënë të rëndësishme apo me nënshkrimin e vet përkatësisht me vulën zyrtare do të vërtetojë dokument, libër apo shkresë zyrtare me përmbajtje të pavërtetë ose me nënshkrimin e vet, përkatësisht me vulën zyrtare do të mundësojë përpilimin e dokumentit, librit apo shkresës zyrtare me përmbajtje të pavërtetë.

Ekzistojnë tri modalitete të falsifikimit të dokumentit: 1. futja e të dhënave të pavërteta ose mosfutja e ndonjë të dhëne të rëndësishme; 2. vërtetimi i dokumentit, regjistrimit a shkresës së rreme; 3. mundësimi i përpilimit të dokumentit, librit a shkresës së pavërtetë, me përmbajtje të rreme.⁶²

⁶⁰ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta zyrtare e RM-së" nr.28, datë 06.02.2014, neni 97, paragrafi 1.

⁶¹ I. Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1269.

⁶² Po aty, faqe 1267.

Kjo veprë penale konsiderohet se është kryer me vet faktin e shënimit të të dhënave të pavërteta apo në rast të mos shënimit të ndonjë të dhëne të rëndësishme.⁶³ Për shkak të natyrës së veprimit kryes, tentativa e veprës penale të kjo formë nuk është e mundur (derisa të mos jetë ndërmarrë veprimi, nuk ka veprë penale). Statusi i kryesit –personit zyrtar a personit përgjegjës tregon se bëhet fjalë për *delictum proprium*.⁶⁴

Vërtetimi duhet të bëhet nga personi zyrtar a personi përgjegjës, ndërsa për ekzistimin e veprës nuk është me rëndësi se cili person e ka përpiluar përmbajtjen e rreme. Bëhet fjalë për formën specifike të falsifikimit intelektual. Kjo formë e veprës penale kryhet me vërtetimin e dokumentit të rremë, regjistrin apo shkresës së rreme. Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje - me vetëdijen se me nënshkrimin e vet apo me vënien e vulës, po vërteton dokumentin zyrtar apo afarist, regjistrin apo shkresën me përmbajtje të rreme. Për ekzistimin e veprës nuk kërkohet ekzistimi i qëllimit që dokumenti i tillë të përdoret si i vërtetë.

Forma e tretë e veprës qëndron në mundësimin e përpilimit të dokumentit, regjistrin ose shkresës me përmbajtje të rreme. Kjo formë e veprës penale konsumohet kur personi zyrtar, me nënshkrimin e vet, përkatësisht me vulën zyrtare i jep mundësi tjetrit të vërë në dorë dokumentin apo regjistrin me përmbajtje të rreme, por me këtë rast kërkohet që personi zyrtar të dijë se personi tjetër në një dokument a regjistër të tillë do të shënojë të dhëna të pavërteta (për shembull, personi zyrtar nënshkruan dhe vërteton formularin e paplotësuar të shtetësisë). Personi zyrtar të kjo formë e veprës penale, në një aspekt, bashkëpunon, bashkëvepron me personin tjetër jozyrtar.

Objekt i veprimit të kësaj veprë janë dokumentet zyrtare apo afariste, librat (regjistrat) ose shkresat zyrtare.

Sipas nenit 122 paragrafi 11 të me dokument nënkuptojm secilin send që është i përshtatshëm apo i caktuar të shërbejë si provë për ndonjë fakt që ka vlerë për marrëdhëniet juridike.

⁶³ Zejneli, Ismail, E Drejta Penale-Pjesa e posacme, Tetovë, 2007, fq 155.

⁶⁴ I. Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1268

Dokument publik është dokumenti i lëshuar nga organi kompetent, organizata apo personi që ushtron punë me interes publik në bazë të ligjit apo dispozite tjetër të bazuar në ligj.⁶⁵

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë personi zyrtar apo personi përgjegjës.

Lidhur me fajësinë, kjo vepër mund të kryhet me dashje e cila duhet të përfshijë edhe vetëdijen e kryerësit të veprës penale që është duke përpiluar dokumentin zyrtar me përmbajtje të pavërtetë.

Për këtë vepër penale është paraparë dënimi me burgim prej 3 muaj deri në 5 vite.

Me këtë dënim, në bazë të paragrafit 2 do të dënohet edhe personi zyrtar i cili dokumentet e latëpërmendura do t'i përdorë në shërbim sikur të jenë të vërteta apo do t'i asgjësojë, fshehë apo do t'i dëmtojë në masë të madhe apo në mënyrë tjetër do t'i bëjë të papërdorshme.

Përgjegjës është dhe dënohet me dënim me burgim prej 3 muaj deri në 5 vjet edhe personi përgjegjës në personin juridik i cili zotëron pasuri shtetërore apo shoqërore, i cili do t'i kryejë veprat nga paragrafët 1 dhe 2.

Të gjitha legjislacionet bashkëkohore sigurinë e qarkullimit juridik, veç të tjerash, e sigurojnë edhe me mbrojtje penalo-juridike. Ajo, si rregull, bëhet duke inkriminuar sjelljet e caktuara, të cilat rrezikojnë qarkullimin juridik. Besimi ndaj autenticitetit të dokumentit ka rëndësi thelbësore kur kemi të bëjmë me dokumentet që i lëshojnë organet shtetërore dhe subjektet e tjera që ushtrojnë autorizime publike, të cilat, me autoritetin e tyre, garantojnë saktësinë e përmbajtjes dhe prejardhjes së dokumenteve të tilla.⁶⁶

⁶⁵ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, "Gazeta zyrtare e RM-së" nr.28, datë 06.02.2014, neni 122. parag. 11.

⁶⁶ I. Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010, fq.1267.

Kapitulli III-të

1. Parandalimi i veprave penale kundër detyrës zyrtare

Masat për parandalimin e korrupsionit në sistemin e drejtësisë merren në radhë të parë nga vetë shteti dhe organet e tij, duke filluar nga policia e shtetit për zbulimin e parandalimin e tij nga prokuroria, e cila nëpërmjet hetimeve zbulon shkaqet e kushtet favorizuese të krimit të korrupsionit dhe nga gjykata si dhe nga organet e larta të drejtësisë.⁶⁷ Me parandalimin e korrupsionit në sistemin e drejtësisë sigurohet rritja e autoritetit të këtyre organeve, besimi i publikut ndaj drejtësisë, konsolidimi i shtetit të së drejtës dhe zhvillimi i demokracisë.⁶⁸

Për veprim të suksesshëm preventiv, zbulim, ndjekje dhe sanksionim të këtyre veprave penale është e nevojshme një qasje më e kordinuar në mes të gjitha institucioneve pavarësisht se në çfarë mënyre do të ndeshet me këtë lloj kriminaliteti, para se gjithash policia, prokuroria dhe gjykatat.⁶⁹

Korrupsioni dëmton shtetin ligjor, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, ul nivelin e qeverisjes së mirë, transparencës dhe drejtësisë shoqërore, pengon konkurrencën, zhvillimin ekonomik dhe rrezikon qëndrueshmërinë e institucioneve demokratike dhe themeleve morale të shoqërisë.

Një luftë efektive ndaj korrupsionit kërkon bashkëpunim ndërkombëtar të gjerë, të shpejtë dhe mirë funksionues në çështjet penale.

Në veprimin preventiv është shumë i rëndësishëm roli i organizatave joqeveritare të cilat duhet edhe më tej pandërprerë të punojnë në ngritjen e vetëdijes së publikut për njohjen e problemit me të gjitha karakteristikat e tij.

Në shumë vende janë nxjerrë ligje të veçanta kundër korrupsionit me të cilat krijohet një bazë konkrete ligjore për luftimin dhe parandalimin e kësaj forme të kriminalitetit. Ndër masat që

⁶⁷ Raport studimor për veprat penale të korrupsionit dhe formave të shpërdorimit të detyrës i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, 2014, fq.28.

⁶⁸ Po aty, fq.28.

⁶⁹ Grup autorësh, Kriminaliteti i organizuar-aspekte juridike, Tetovë, 2009, fq.189.

parashihen në këto ligje është edhe konfiskimi dhe marrja e pasurisë apo të mirave të tjera materiale të cilat janë rezultat i korrupsionit.⁷⁰

Maqedonia e Veriut ka ende shumë punë për të bërë sa i përket luftës kundër korrupsionit. Krahas masave dhe mjeteve që janë të parapara në shtetet nacionale, ekzistojnë edhe masa, mjete dhe instrumente të ndryshme të karakterit ndërkombëtar.⁷¹

Lufta kundër korrupsionit paraqet proces botëror në korniza të të cilave janë sjellë:

- Rezoluta e KB kundër korrupsionit dhe mitos;
- Deklarata e KB për ndalimin e mitos në transaksionet ndërkombëtare;
- “Lista e zezë” e Bankës Botërore të ndërmarrjeve të cilat shërbejnë me korrupsion;
- Konventa për ndalimin e larjes së parave;
- Konventa e organizatës së Shteteve Amerikane për luftën kundër korrupsionit.⁷²

Si masë mjaft e rëndësishme në pengimin e përfshirjes së zyrtarëve të lartë publik në korrupsion dhe disa forma të krimit të organizuar konsiderohet edhe deklarimi dhe regjistrimi i gjendjes së pasurisë dhe prejardhjes së saj, si dhe burimi i të ardhurave që ata realizojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.⁷³

2. Roli i policisë në parandalimin e veprave penale kundër detyrës zyrtare

Funksioni kryesor i Policisë është mbrojtja dhe respektimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ligje dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare, mbrojtje të rendit juridik, parandalimin dhe zbulimin e veprave penale, marrjen e masave për ndjekjen penale të autorëve si dhe ruajtjen e rendit publik dhe paqes në shoqëri.⁷⁴

⁷⁰ Halili.Ragip, Kriminologjia, Prishtinë 2011, fq. 202.

⁷¹ Gashi, Rexhep, Krimi i Organizuar, Prishtinë 2014, fq.125.

⁷² Grup autorësh, Kriminaliteti i organizuar-aspekte juridike, Tetovë 2009, fq.190.

⁷³ Gashi, Rexhep, Krimi i Organizuar, Prishtinë 2014, fq.158.

⁷⁴ Ligji për policinë, Shkup 2015, neni 3.

Punët e policisë, sipas LPP janë veprimet e punonjësve të policisë që kryesisht konsistojnë në:

- mbrojtja e jetës, sigurisë personale dhe pronës së qytetarëve;
- mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ligjet dhe marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare;
- parandalimi për kryerjen e krimeve dhe kundërvajtjeve, zbulimin dhe kapjen e autorëve të tyre dhe marrjen e masave të tjera të përcaktuara me ligj për të ndjekur penalisht autorët e këtyre krimeve dhe shumë veprimari tjera të përcaktuara me ligj.

Në luftimin e kriminalitetit nuk ka asgjë më të rëndësishme se marrja në kohë e informacionit. Kjo mundëson që policia të veprojë, para se të kryhet vepra penale, në mënyrë proaktive dhe të pengoj kryerësin që të shkaktojë pasojën e mundshme.

Në punën e policisë, marrja e informacionit me vonesë, shpeshherë nënkupton edhe humbje jete, dëme pronësore dhe çështje tjera negative të aspektin e sigurisë. Policia është shfrytëzuesi më i madh i informacioneve, kurse ai i cili i ka informacionet , ka diturinë dhe fuqinë.

Shërbimet e policisë që merren me grumbullimin e informacioneve, në përgjithsi ndahen në dy grupe: shërbime publike , që janë të lidhura me sigurinë e qytetarëve dhe shërbimet e fshehta-sekrete që janë të lidhura me sigurinë e shtetit dhe të qytetarëve.

Kusht i domosdoshëm për ngritjen e aktiviteteve të policisë dhe veprimeve operative, në aspektin e marrjes së masave dhe aktiviteteve të nevojshme për zbulimin e veprave penale dhe të kryerësve të tyre, është marrja e informacionit se është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. Informacion ky i cili mund të merret në rrugë të ndryshme.

Policia është organi më i thirur që të parandaloj dhe zbuloj të gjitha dukuritë negative në shoqëri, sidomos kriminalitetin. Në kuptimin e taktikës së zbulimit kemi vepra penale për ekzistimin e të cilave nuk dihet fare, madje as që dyshohet (spiunazhi, falsifikimi, korrupsioni, etj) por në bazë të sjelljes së kryerësit mund të dyshojmë se merret me diçka të ndaluar.⁷⁵

Veprimtaria e policisë është e shumëfishtë. Policia, duke vepruar në parandalimin dhe zbulimin e krimit i ofron prokurorit publik dhe gjykatës material të nevojshëm për fillimin e procedurës penale: gjatë zhvillimit të procedurës penale ofron ndihmë kriminalistike lidhur me identifikimin

⁷⁵ Avziu, Qebir, Kriminalistika, Tetovë, 2015.

e personave dhe të sendeve (marrja e shenjave të gishtërinjve, marrja e materialit biologjik për analizë të ADN-së, etj) ofron ndimë për ekzekutimin e vendimeve, jep të dhëna nga evidnencat e caktuara, etj.⁷⁶

Me ndryshimet në LPP në rikonstruimin e procedurës hetimore veprimtaria operative hetimore nga ish gjyqtari hetues kalon në kompetencë të prokurorit publik dhe nëpërmjet tij edhe në kompetencë të policisë. Me ç’rast zgjerohen edhe kompetencat e policisë në procedurë penale.

Detyra e Policisë së jurisprudencës është që sipas detyrës zyrtare ose me urrdhër të prokurorit publik të ndermerr masa dhe aktivitete me qëllim të zbulimit dhe hetimit kriminalistik të veprave penale, parandalimit të pasojave të mëtutjeshme të veprave penale, kapjes dhe denoncimit të kryerësve të tyre, sigurimit të provave, masave dhe aktiviteteve tjera të cilat mund të shfrytëzohen për realizimin e papenguar të procedurës penale. Ajo zbaton hetim dhe veprime të urdhëruara ose të ngarkuara nga gjykata apo prokuroria publike.⁷⁷

Për kryerjen e punëve policore që kërkojnë një shkallë të lartë specializimi, dhe për kryerjen efektive dhe ekonomike të detyrave të caktuara specifike dhe komplekse, si dhe për nevojat e sektorëve të brendshëm dhe qendrat rajonale për punë kufitare, mbi parimin e funksionimit të centralizuar, formohen Shërbimet Qendrore të Policisë, të cilat i kryejnë punimet në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.⁷⁸

Në Shërbimet Qendrore të Policisë funksionon një njësi organizative për luftimin e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, përgjegjëse për parandalimin dhe zbulimin e shumë veprave penale ndër të cilat: veprat penale e keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe autoritetit nga neni 353 paragrafi (5), marrja e ryshfetit me vlerë të konsiderueshme nga neni 357 dhe ndërmjetësimi i paligjshëm sipas nenit 359, të gjitha nga Kodi Penal, të kryera nga një person i zgjedhur ose emëruar, person zyrtar ose person përgjegjës në personin juridik.⁷⁹

⁷⁶ Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, Edrejta e procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq.93.

⁷⁷ Po aty, fq.94.

⁷⁸ Ligji për policinë, Shkup, 2015, neni 17.

⁷⁹ Po aty, neni 18, paragrafi 1.

Policia është institucion me rëndësi jetike për një demokraci. Punonjësit e policisë janë krijesa të ligjit dhe ata nuk duhet të kenë asnjë mëdyshje se ligji dhe rregullat duhen respektuar dhe zbatuar gjithmonë.

Kodi etikës policore obligon policët që të kundërshtojnë çdo formë korrupsioni brenda policisë. Çdo polic njofton eprorët dhe organet tjera shtetërore kompetente për paraqitjen e korrupsionit në kuadër të policisë.⁸⁰

Për të ruajtur integritetin e qëndrueshëm të policisë, si dhe funksionimin e duhur të Policisë në përputhje me sundimin e ligjit, masa efektive do të vendosen në të gjitha nivelet brenda organizatës policore për të parandaluar dhe luftuar në mënyrë të efektshme korrupsionin, duke definuar sjelljen korruptive dhe duke vendosur struktura organizative dhe mekanizma të kontrollit për të luftuar korrupsionin.⁸¹

Policët nuk mund të përdorin kompetencat e tyre zyrtare për të fituar përfitime personale.⁸² Për të fituar besimin e publikut, policia duhet t'i përmbahet kodit të sjelljes profesionale dhe të tregojë profesionalizëm dhe integritet.

Prandaj, zyrtarët policorë duhet të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me: standarde të pranuar në mënyrë universale për të drejtat e njeriut dhe të drejtat civile dhe politike. Mbrojtja dhe ruajtja e jetës duhet të jetë përparësia e tyre më e lartë.

Nuk mjafton që punonjësit e policisë të mendojnë në mënyrë etike. Ata duhet që dhe të veprojnë në mënyrë etike.

3. Roli i prokurorisë në parandalimin e veprave penale kundër detyrës zyrtare

Sipas nenit 106 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Prokuroria Publike përcaktohet si organ i vetëm dhe i pavarur shtetëror që i ndjek autorët e veprave penale dhe të

⁸⁰ Kodi etikës policore, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.72, 11.06.2007, neni 47.

⁸¹ Kodi etikës policore, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.72, 11.06.2007, neni 21.

⁸² Kodi etikës policore, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.72, 11.06.2007, neni 21, par.3.

veprave të tjera të dënueshme me ligj, e po ashtu kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj. Prokuroria Publike i kryen funksionet e saj në bazë dhe në kuadër të Kushtetutës dhe ligjit. Detyra e prokurorisë publike është zbulimi në kohë i veprave penale të kryera dhe zbulimi i kryerësve të tyre.

Ndjekja e kryerësve të veprave penale, përfshin fillimin e procedurës penale, përfaqsimin e akuzës para gjykatës dhe paraqitjen e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Prokurori publik është i autorizuar t'i marrë të gjitha masat e nevojshme, mjetet juridike për zbulimin e veprave penale dhe veprave tjera ndëshkuese dhe kryerësve të tyre, të ndërmarrë mjetet juridike të rregullta ose të jashtëzakonshme kundër vendimeve gjyqsore, kujdeset për zbatimin e sanksioneve të shqiptuara për vepra ndëshkuese dhe mbrojtjen e të drejtave të personave për të cilët është caktuar paraburgim, të ndërmarrë të gjitha veprimet në kuadër të funksionit themelor të prokurorit publik dhe të përfaqsoj padi.⁸³

Prokuroria publike organizohet sipas parimeve të hierarkisë dhe subordinimit.⁸⁴

Prokuroria publike është e rregulluar ashtu që prokuroria publike e rangut më të lartë ka mundësi t'i jap udhëzime dhe rekomndime prokurorisë publike të rangut më të ulët, me ç'rast prokuroria publike e rangut më të ulët detyrohet të veprojë sipas udhëzimeve të rekomanduara.

Regullimi i prokurorisë publike bazohet në disa parime të veçanta: parimi i hierarkisë, parimi i devolucionit, parimi i substitucionit dhe parimi i vendosjes në mënyrë monokrate.

Në vargun e organizmit të prokurorive publike i hasim këto lloje të prokurorisë:

- Prokurorinë publike të RMV-së;
- Prokuroritë publike të larta;
- Prokuroritë publike themelore;
- Prokurorinë publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.⁸⁵

⁸³ Zejneli Jusuf, Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë, Tetovë, 2013, fq.159.

⁸⁴ Ligji për Prokurorinë publike, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.150, 12.12.2007, neni 6.

⁸⁵ Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, Edrejta e procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq.92.

Prokuroria Themelore Publike për ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit është kompetent të veprojë edhe për veprat penale shpërdorim të pozitës zyrtare dhe autoritetit sipas nenit 353 paragrafi (5), marrjes së ryshfetit me vlerë të konsiderueshme nga neni 357 dhe ndërmjetësimit të paligjshëm nga neni 359 të Kodit Penal të kryera nga funksionar i zgjedhur apo i emëruar, person zyrtar apo person përgjegjës në personin e huaj juridik.⁸⁶

Për çështje të rëndësishme ajo bashkëpunon me organet e zbulimit të veprave penale, gjykatat, organet dhe personat tjerë juridik.

Prokurorët publik në marrëdhëniet me policinë dhe organet e tjera shtetërore që veprojnë në procedurën para hetimit do të veprojnë në atë mënyrë që inkurajojnë bashkëpunimin, duke dhënë udhëzime të qarta dhe marrjen e vendimeve të kuptueshme në përputhje me ligjin, kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre.⁸⁷

Me ushtrimin e kompetencave që ka prokuroria publike, mer masa që të mbrojnë të drejtat dhe liritë e qytetarëve, interesat shtetërore, zhvillon efikasitetin në kapjen e kryerësve të veprave penale dhe të veprave tjera ndëshkuese.

Prokurorët publik do të japin udhëzime dhe urdhëra për policinë dhe organet e tjera shtetërore që veprojnë në procedurën para hetimit në mënyrë të ligjshme dhe të rregullt, në mënyrë që të mos vihet në dyshim veprimet e policisë dhe organeve të tjera shtetërore, dhe nëse përcaktojnë që abuzimi është kryer dhe ligji është shkelur, do marrin masat e nevojshme në përputhje me kompetencat e tyre.

Prokurorët publik për të luftuar korrupsionin në organet e administratës shtetërore përmes veprimit të tyre për raste konkrete për vepra penale të kryera nga punonjësit në këto organe, ata do t'i paraqesin organit përkatës të administratës shtetërore të dhënat dhe provat përkatëse të nevojshme për ndërprerjen e veprimeve korruptive dhe parandalimin e kryerjes së mëtejshme të krimeve të tilla, si dhe për veprat tjera penale që mund të ndikojnë në integritetin e organeve të administratës shtetërore.⁸⁸

Prokurori publik e orientojnë punën e puntorëve të autorizuar në ministrinë e punëve të brendshme dhe organet e tjera shtetërore kompetente për ndërmarrjen e masave për zbulimin

⁸⁶ Ligji për Prokurorinë publike, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.150, 12.12.2007, neni 31.

⁸⁷ Kodi Etik i Prokurorëve Publik, PPRM, nr. 725/ 14, Shkup, Dhjetor 2014, neni 15.

⁸⁸ Kodi Etik i Prokurorëve Publik, PPRM, nr. 725/ 14, Shkup, Dhjetor 2014, neni 21.

e kryerësve të veprave penale, sigurimin e gjurmëve të veprës penale dhe lëndëve që mund të shërbejnë si dëshmi.

Funksioni, Prokuror Publik i RMV-së, është i papajtueshëm me antarësinë në parti politike, ose me ushtrimin e funksioneve të tjera dhe profesioneve publike, të caktuara me ligj. Poashtu, ndalohet edhe organizimi dhe veprimi politik në Prokurorinë publike.⁸⁹

Prokurorët publik në kryerjen e detyrave të tyre, në marrëdhëniet me organet e tjera, palët dhe qytetarët, në publik, si dhe në marrëdhëniet e ndërsjella janë të detyruar t'u përmbahen parimeve të mëposhtme:- parimi i ligjshmërisë, parimi i paanshmërisë dhe ligjshmërisë, parimi i zellit dhe veprimit profesional, parimi i ndershmërisë dhe paprekshmërisë, parimi i profesionistit, parimi i dinjitetit dhe parimi i kufizimit.

Ajo e informon opinionin për gjendjen e kriminalitetit dhe për çështjet tjera me rëndësi të përgjithëshme përmes shtypit dhe mjeteve tjera të informimit.

Përveç funksionit të hetimit dhe të ndjekjes së veprave penale në procedurë penale, në planin e gjerë të luftës kundër kriminalitetit, prokuroria publike ka të drejtë dhe detyrë t'i përcjell dhe t'i studiojë marrëdhëniet dhe dukuritë shoqërore të rëndësishme për realizimin e funksionit të tyre dhe, për vrojtimet e veta ta njoftojë Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe të jep propozime për parandalimin e dukurive të rrezikshme dhe të dëmshme për shoqërinë si dhe për përforcimin e sundimit të ligjit. Prokuroria publike po ashtu ka të drejtë edhe për detyrë që të informojë opinionin lidhur me gjendjen e kriminalitetit dhe për problemet dhe dukuritë tjera me rëndësi të përgjithshme, të cilat i ka vërejtur në punën e vet.⁹⁰

4. Roli i gjykatave në parandalimin e veprave penale kundër detyrës zyrtare

Në RMV pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat. Gjykatat paraqesin një ndër institucionet më të rëndësishme dhe më të vjetra që mbrojnë interesat dhe vlerat themelore të shoqërisë.⁹¹

⁸⁹ Kushtetuta e RMV-së, nr.08-4642/1, 17 nëntor 1991, neni 107.

⁹⁰ Sahiti Ejup, Zejneli Ismail, Edrejta e procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq.91.

⁹¹ Saliu, Kurtesh, E Drejta Kushtetuese, Tetovë 2002, fq.382

Sipas kushtetutës së vendit Gjykatat janë organe të mëvetësishme dhe të pavarura. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës, të ligjeve dhe të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare. Gjykata është subjekt themelor i procedurës penale. Ajo në procedurë penale ushtron funksionin e gjyimit, mirëpo funksioni i saj nuk kufizohet vetëm në funksionin e gjyimit.⁹²

Pavarësia e gjykatave, varet nga niveli i demokracisë në një shtet. Sa me demokratik të jetë shteti, aq më të pavarura janë edhe gjykatat. Gjykatat luajnë një rol të rëndësishëm, në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, të kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë.⁹³

Shteti ligjor paraqet një koncept të gjërë juridiko-politik, i cili në vete ngërthen një varg parimesh me të cilat sigurohet sundimi i ligjit dhe marrëdhëniet demokratike në shoqëri. Ndër parimet kryesore të shtetit ligjor është edhe gjyqësia e pavarur. Pavarësia e gjykatave nënkupton ekzistimin e gjykatave të pavarura dhe punën e tyre në pajtim me ligjin. Parimi i pavarësisë ose legalitetit në ushtrimin e pushtetit shtetëror gjyqsor nënkupton vënien e gjykatës nën ligj, në të cilën mënyrë përjashtohen arbitrazhizmi dhe parimi i oportunitetit politik në punën e gjykatës.⁹⁴

Gjykatat mbrojnë interesat dhe vlerat themelore të shoqërisë. Të gjithë kanë të drejtë të kenë qasje të barabartë në drejtësi në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të tyre. Në marrjen e vendimeve për të drejtat dhe detyrimet civile dhe në marrjen e vendimeve për përgjegjësinë penale, secili ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme të vendosur me ligj.⁹⁵

Si bartës i njërës nga segmentet kryesore të pushtetit, funksionimi i gjyqësisë paraqet segment i cili kujdeset për sigurimin, afirmimin e sigurisë juridike, duke patur rol të rëndësishëm në zbatimin e parimeve të sundimit të së drejtës, mbrojtjes së të drejtave dhe lirive individuale dhe kolektive, me qëllim të mundësimit të zbatimit të parimeve progresive dhe standardeve të demokracisë. Veprimtaria efikase e saj mundëson që demokracia të mos vendoset në rezik.⁹⁶

⁹² Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, Edrejta e procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq.68.

⁹³ Lumani, Fatmire, E Drejta Kushtetuese, Tetovë, 2014 fq.240.

⁹⁴ Saliu, Kurtesh, E Drejta Kushtetuese, Tetovë, 2002, fq.100.

⁹⁵ Ligji për gjykata, Shkup, 2006, nr. 07-1912/1, neni 6.

⁹⁶ Zejneli, Jusuf, Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë, Tetovë, 2013, fq.147.

Sipas nenit 22 të Ligjit mbi gjykata të RMV-së pushtetin gjyqësor e ushtrojnë Gjykatat Themelore, Gjykatat e Apelit, Gjykata Administrative dhe Gjykata Supreme e RMV-së.

Gjykatat themelore themelohen për një ose më shumë komuna dhe kanë kompetencë lëndore themelore ose të zgjeruar. Në kuadër të disa gjykatave themelore me kompetencë të zgjeruar, ndër të cilat edhe Gjykata themelore në Tetovë themelohen seksione gjyqësore të specializuara që do të veprojnë në konteste të llojeve të caktuara.

Llojet, kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si dhe procedura para tyre, rregullohen me ligj, i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.⁹⁷

Si parime të punës së gjykatave janë :

- parimi i marrjes në pyetje: obligimi i gjykatës është që të marrë në pyetje secilin, para se t'i shqiptohet dënimi;
- ballafaqimi i palëve që nënkupton sigurimin e mundësisë, secilës palë, që para gjykatës drejtpërdrejtë t'i kundërvihet palës tjetër dhe drejtpërdrejtë t'i kundërshtojë pohimet e saj;
- parimi verbal: nënkupton të drejtën e palës që para gjykatës, t'i shqyrtojnë çështjet me gojë;
- parimi publik: puna pubike e gjykatës;
- parimi i dyshkallësisë: nënkupton të drejtën e palës të kundërshtojë vendimet e gjykatës së shkallës së parë.

Faktori kryesor që ndikon në eficensën e luftës ndaj korrupsionit është integriteti dhe ndershmëria e vetë zyrtarëve të sistemit të drejtësisë.

Gjyqtarët nuk mund të përdorin funksionin gjyqësor për interesa personale apo për në interes të ndonjë anëtarit të familjes apo kushdo qoft. Gjykatësi dhe antarët e familjes së tij nuk duhet të pranojnë, dhe as të kërkojnë ndonjë dhuratë , hua apo shërbime të tjera në lidhje me diçka

⁹⁷ Kushtetuta e RMV-së, nr.08-4642/1, 17 nëntor 1991, neni 98.

që gjykatësi mund të bëjë përkatësisht të mos e bëjë këtë në lidhje me kryerjen e funksionit gjyqësor, me përjashtim të dhuratave përkatëse vlera e të cilave nuk e tejkalon shumën e përcaktuar me ligj.

Reformat në sistemin gjyqësor insistojnë në marrjen e masave dhe aktiviteteve për përmirësimin e organizimit, administrimit, kushteve materiale dhe kuadrove për realizimin e funksionit themelor të sistemit gjyqësor, duke përfshirë sundimin e së drejtës, mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve si dhe vendosjen e sigurisë juridike e cila paraqet garanci për efikasitetin e funksionimit të shoqërisë në tërësi.

Në mosefikasitetin e gjykatave ndikon edhe mungesa e personelit ndimës, mungesa e gjyqeve të specializuara, mjeteve financiare dhe faktorë të tjerë.

Krijimi i sistemit gjyqësor të pavarur dhe efikas në vete përfshin realizimin e disa qëllimeve esenciale dhe atë: sundimin e së drejtës, aritjen e efikasitetit më të lartë në punën e gjykatësve, mbrojtjen e drejtave të njeriut dhe forcimin e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

5. Roli i mas-mediave në parandalimin e veprave penale kundër detyrës zyrtare

Media masive i referohet një grupi të larmishëm të teknologjive të mediave që arrijnë një audiencë të madhe përmes komunikimit masiv.

Mjetet e komunikimit masiv konsiderohen: shtypi, literatura, radio, televizioni, filmi, interneti, etj.,

Liria e shprehjes së lirë të mendimit, informimit publik dhe themelimi i lirë i institucioneve për informim publik, qasja e lirë ndaj informacioneve, liria e pranimi dhe transmetimit të informatave, e drejta e përgjigjes dhe e drejta e përmirësimit në mjetet e informimit, e drejta e mbrojtjes së burimit të informacionit dhe ndalesa e censurës janë të garantuara me Kushtetutë (neni 16 i Kushtetutës).

Masmedia apo ndryshe i njohur si “aparati” që organizojnë proceset e prodhimit dhe të shpërndarjes së informacionit.

Të gjithë, kemi të drejtën e fjalës së lirë, mirëpo duhet pasur kujdes çfarë thuhet pasi çdo fjalë mund të kthehet në veprim të paligjshëm në shoqëri. Me fuqinë e lirisë së shtypit vjen po ashtu edhe përgjegjësia.

Sot, të gjithë mjetet e komunikimit si ato të shkruara po ashtu edhe ato elektronike mund të shfrytëzohen si mjet për kryerjen e veprave të shumta penale si: shpifje dhe fyerje, zbulim i sekretit afarist, shtetëror, ushtarak ose zyrtar, provokim i urrejtjes nacionale, racore dhe fetare, thirrje për luftë agresive dhe vepra të tjera, veprimi i të cilave përbëhet nga kanosja dhe shkelja e të mirës së mbrojtur në mënyrë verbale apo në mënyrë tjetër.

Për veprat e kryera nëpërmjet masmediave vlejnë rregullat e përgjithshme të përgjegjësisë penale dhe pjesmarrjen e më shumë personave në kryerjen e veprës penale.⁹⁸

Mjetet e komunikimit masiv në botën bashkëkohore janë bërë mjete të fuqishme të ndikimit dhe orientimit të opinionit brenda një vendi apo opinionit ndërkombëtar. Mjetet e ndryshme të komunikimit masiv janë në gjendje që për një kohë të shkurtër të orientojnë opinionin në kahje të ndryshme.

Sot në botën bashkëkohore, bëhet një luftë e madhe për kontrollin, dominimin dhe pushtetin mbi mjetet e informimit.⁹⁹ (Kambovski, 2010)

Mjetet e komunikimit masiv kanë rol të madh në zhvillimin dhe formimin e personalitetit të njeriut, e veçmas të gjeneratave të reja. Roli pozitiv i mjeteve të komunikimit masiv vërehet edhe në formimin dhe zhvillimin e gjeneratave të tëra.

Mjetet e komunikimit masiv në raste jo të pakta paraqiten edhe si faktor kriminogjen. Përveç rolit pozitiv që kanë këto mjete, në disa raste flitet edhe për ndikimin e tyre në kriminalitet. Ndikimi i mjeteve të komunikimit në paraqitjen e kriminalitetit vjen në shprehje në rastet kur përmes këtyre mjeteve prezantohen përmbajtje të cilat kanë vlera të dyshimta morale, vlera të dyshimta artistike, pseudovlera shkencore apo vlera të dobëta dhe destruktive.

Zakonisht kur flitet për ndikimin e mjeteve të komunikimit masiv në paraqitjen e formave të ndryshme të krimit, bëhet fjalë për disa forma të përmbajtjeve të këtyre mjeteve, të cilat në

⁹⁸ Kambovski, Vllado, E Drejta Penale-Pjesa e Posacme, Shkup, 2010, fq. 308.

⁹⁹ Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011, fq. 262.

mënyrë të detajuar përshkruajnë dhe prezantojnë vendin e kryerjes së krimit të organizuar, kohën e kryerjes së tij, mjetet e kryerjes së tij, mënyrën e fshehjes së gjurmëve, mënyrën e shmangies nga organet e zbulimit dhe të ndjekjes së kryerësve të tij, mënyrën e ikjes nga përgjegjësia penale, etj. Paraqitjet e tilla mund të kenë ndikim në nxitjen e kryerësve potencial, e sidomos të personave të rinj të cilët akoma nuk janë në gjendje që t'i gjykojnë përmbajtjet e tilla, në mënyrë që ata të jepen pas disa formave të kriminalitetit.¹⁰⁰

Shpersherë, duke shfrytëzuar masmediat dhe duke keqpërdoruar ndikimin dhe pozitën në mjetet e informimit, regjimet e ndryshme, partitë në pushtet, grupet dhe pronarët e mjeteve të ndryshme të informimit përpiqen ta orientojnë masën në objektivin e dëshiruar, bëjnë diskreditimin dhe njollosjen e individëve, partive apo grupeve të ndryshme kundërshtare.

Shtetet në të cilat pushteti është i korruptuar ose është i paaftë t'i kundërvihet krimit, në zbatimin e funksioneve të organeve të zbulimit, ndjekjes, gjykimit dhe ekzekutimit orientohej në forma të luftës kundër këtij krimi. Një ndër këta mënyra është edhe shfrytëzimi i mjeteve të informimit në stigmatizimin (shënjim) të kryerësve të veprave penale ose kritikën e institucioneve dhe organeve të caktuara që kanë ngecur në luftë kundër këtij lloji krimi.¹⁰¹

Kapitulli IV-t

1. Rastet nga praktika gjyqësore

Në këtë kapitull do të paraqesim të dhëna nga praktika gjyqësore për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe kryesisht në Gjykatën Themelore të Tetovës për periudhën 2014-2018.

¹⁰⁰ Gashi, Rexhep, Krimi i Organizuar, Prishtinë, 2014, fq.121

¹⁰¹ Grup autorësh, Kriminaliteti i organizuar-aspekte juridike, Tetovë, 2009, fq.122.

Tabela 2: Personat e moshës madhore të paraqitur, të akuzuar dhe të dënuar sipas llojeve të veprave penale, sipas viteve

Burimi: Enti Shtetëror i statistikave RMV

		2014	2015	2016	2017	2018
Veprat penale kundër detyrës zyrtare	Të paraqitur	566	664	613	593	640
	Të akuzuar	355	279	187	152	123
	Të dënuar	243	201	113	96	92

Nga tabela e paraqitur më lartë nga të dhënat statistikore të siguruar nga enti shtetror i statistikave të RMV-së, kemi të paraqitura veprat penale kundër detyrës zyrtare në periudhën 2014-2018 në RMV. Në këtë periudhë kemi gjithsej 3076 raste të paraqitura të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në të gjithë teritorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nga numri i përgjithshëm i veprave të paraqitura për 1096 është ngritur akuzë dhe vetëm 745 prej tyre janë dënuar.

Nga tabela e mësipërme ajo që vërejm është se nuk kemi një rënie të veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare të paraqitura por një ngritje dhe rënie të vazhdueshme ndër vite. Mirpo krahas kësaj numri i të akuzuarve dhe i të dënuarve për vepra penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare bie vazhdimisht duke shënuar numrin më të lartë në vitin 2014 dhe atë 355 të akuzuar dhe 243 të dënuar nga gjithsej 566 rastet e paraqitura në këtë vit dhe numrin më të ulët në vitin 2018 me 123 të akuzuar dhe 92 të dënuar nga gjithsej 640 rastet e paraqitura.


Në Gjykatën Themelore të Tetovës në periudhën kohore nga viti 2014 deri në vitin 2018 janë pranuar gjithsej 60 lëndë në kuadër të veprës penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare të paraparë në kapitullin XXX të Kodit Penal përkatësisht në nenin 353.

Të dhënat e siguruar nga Gjykata Themelore e Tetovës për periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2018 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme ku parashihet numri i lëndëve të evidentuara të veprës penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare në Gjykatën Themelore në Tetovë.

Tabela 3: Veprat penale kundër detyrës zyrtare të evidentuara në Gjykatën Themelore të Tetovës në periudhën 2014-2018

	Veprat penale kundër detyrës zyrtare				
	2014	2015	2016	2017	2018
Veprat penale të evidentuara	22	17	9	4	8

Grafiku 1: Paraqitja grafike për veprat penale kundër detyrës zyrtare të evidentuara në Gjykatën Themelore të Tetovës në periudhën 2014-2018



Në bazë të analizës së statistikave për periudhën 2014-2018, në vitin 2014 kemi numrin më të madh të rasteve të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, dhe atë 22 raste. E paraqitur përmes grafikonit 1, viti 2014 shënon kulmin e rasteve të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

Në vitet në vijim siç mund të shohim edhe në grafikonin e paraqitur më lartë shënohet një rënie, në vitin 2015 janë regjistruar 17 raste, në vitin 2016 janë regjistruar 9 raste, dhe vetëm 4 raste në vitin 2017. Viti 2017 i paraqitur në grafikon shënon pikën më të ulët apo vitin me më pak keqpërdorime të detyrës zyrtare.

Në vitin 2018, në bazë të statistikave për dallim nga viti 2017 dhe vitet pararendëse ku numri i veprave penale të evidentuara binte dukshëm, është ritur duke shënuar 8 raste të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

Në Gjykatën Themelore të Tetovës në periudhën prej vitin 2014 deri në vitin 2018 kryesisht janë paraqitur vetëm disa dhe jo gjitha veprat penale të cilat përfshihen në korpusin e veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare të kapitullit XXX.

Brenda kësaj periudhe janë evidentuar vepra penale që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e pozitës dhe autorizimit zyrtar (neni 353), shkelja e ruajtjes së kufirit shtetëror (neni 353-a), të punuarit e pandërgjegjshëm gjatë detyrës (neni 353-c), shpërdorimi i shërbimit (neni 354), marrja e rryshfetit (neni 357) dhe falsifikimi i dokumentit zyrtar (neni 361).


Tabela 4: Llojet e veprave penale të Keqpërdorimit të detyrës zyrtare të evidentuara në Gjykatën Themelore në Tetovë në periudhën 2014-2018.

	2014	2015	2016	2017	2018
Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar - Neni 353	19	15	7	2	6
Shkelja e ruajtjes së kufirit shtetëror - Neni 353-a	1	0	0	0	0
Të punuarit e pandërgjegjshëm gjatë detyrës - Neni 353-c	1	1	1	0	0
Shpërdorimi i shërbimit - Neni 354	0	0	1	2	2
Marrja e rryshfetit - Neni 357	1	0	0	0	0
Falsifikimi i dokumenteve zyrtare - Neni 361	0	1	0	0	0

Në tabelën e paraqitur më lartë mund të vërejm se vepra penale e cila paraqitet me numrin më të madh të kryerësve është vepra penale nga neni 353, “ Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar” me gjithsej 49 raste të evidentuara në periudhën 2014-2018.

Kjo vepër penale në periudhën kohore nga viti 2014 deri në vitin 2017 shënon një rënie të konsiderueshme nga 19 raste në vitin 2014 në vetën 2 raste të evidentuara brenda vitit 2017. Mirpo në vitin 2018 shënohet përsëri një ritje duke u regjistruar 6 vepra penale të keqpërdorimit të pozitës dhe autorizimit zyrtar.

Grafiku 2: Në grafikun e mëposhtëm do të paraqesim të dhënat statestikore, të shprehura në përqindje për këtë veprën penale.



Nga paraqitja grafike e të dhënave statestikore mund të vërejm se në periudhën 2014-2018 në Gjykatën Themelore në Tetovë, në vitin 2014 është regjistruar numri më i lartë i veprave penale të keqpërdorimit të pozitës dhe autorizimit zyrtar me 39 %, më pas viti 2015 me 31 %, vijon viti 2016 me 14 %, në vitin 2015 shënohet numri më i ulët i veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare me 4% dhe në vitin 2018 janë kryer 12 % të veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

Në tabelën e paraqitur krahas veprës themelore të Keqpërdorimit të pozitës dhe autorizimit zyrtar, në përgjithsi vërehen edhe vepra tjera penale mirpo në numër shumë të vogël.

Përmes tabelës në vijim do të paraqesim statistikat për llojet e dënimeve për veprat penale të evidenuara në Gjykatën Themelore të Tetovës për veprën penale Keqpërdorimi i detyrës dhe autorizimit zyrtar të paraparë në nenin 353 të Kodi Penal.

Tabela 5: Llojet e dënimeve për veprat penale të Keqpërdorimit të detyrës zyrtare në Gjykatën Themelore të Tetovës në periudhën 2014-2018.

	Dënim me burg	Dënim me kusht	Dënim me gjobë	Liruar nga akuza	Nuk është vepër penale sipas ligjit	Akuza është refuzuar
2014	1	11	3	2	1	1
2015	2	10	2	2	/	1
2016	1	3	/	4	/	/
2017	1	1	/	1	1	/
2018	1	/	/	3	1	/

Nga tabela e mësipërme vërejm se më së shumti në periudhën prej vitit 2014 deri në vitin 2018 është shqiptuar dënimi me kusht dhe atë gjithsej 25 herë.

Dënimi me burg është shqiptuar gjithsej 6 herë, dënimi me gjobë vetëm 5 herë, në 12 raste kryerësi e veprave penale janë liruar nga akuza dhe 2 herë akuza është refuzuar. Në 3 raste vepra e evidentuar nuk është konsideruar vepër penale sipas ligjit.

Krahas këtyre dënimeve 2 herë brenda viteve 2014-2018 janë sjellë vendime për kompetencë, një herë në vitin 2018 është sjellë vendim sipas të cilit ekzistojnë kushte të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të kryerësit.

Në periudhën 2014-2018 në Gjykatën Themelore të Tetovës në bazë të statistikave të siguruar nga kjo gjykatë janë sjellë gjithsej 59 vendime.

2. Raset nga praktika gjyqsore marrja e ryshfetit

Vepra penale “Marrja e ryshfetit” e paraparë në nenin 357 të Kodi Penal, në periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2018 në Gjykatën Themelore të Tetovës është evidentuar vetëm një herë në vitin 2014.

Kjo vepër penale është evidentuar me numër të lëndës K-102/14. Kryerësit të kësaj veprë penale i është shqiptuar masë alternative dënim me kusht sipas të cilës dënimi me burg prej 6 muaj nuk do të ekzekutohet në qoftë se brenda një viti nuk do të kryejë vepër të re penale.

Gjatë elabolimit të punimit shpesh kemi përmendur karakteristikat e përgjithshme të kryerësve të këtyre veprave penale, ndërsa në këtë pjesë do të cekim karakteristikat individuale të kryerësit të vetëm të evidentuar në periudhën katër vjeçare për marrje të ryshfeti në Gjykatën Themelore të Tetovës.

Kryerës i kësaj veprë penale është shtetasi S. V, nacionaliteti maqedonas, shtetas i RMV-së, i lindur në vitin 1964 në Tetovë por me vendbanim në Shkup. I akuzuari ishte i martuar, babai i dy fëmijëve, nuk ka qenë i gjykuar më parë dhe ndaj tij në momentin e kryerjes së veprës nuk ka pasur procedurë tjetër.

Për shkak të natyrës së këtyre veprave penale kryerës të tyre mund të jenë vetëm personat me përgatitje profesionale që janë ushtrues të detyrave të besuara zyrtare. Kryerësi në këtë rast karakterizohet me arsim të lartë, ekonomist e diplomuar, drejtues për kontroll të brendshëm në Mepso, me të hyra mujore prej 54.000 den.

Kryerësi i kësaj veprë penale akuzohet dhe është dënuar për veprën penale Marrje ryshfeti në bazë të nenit 357 paragrafi 2 i Kodit Penal.

3. Raset nga praktika gjyqësore shpërdorim i shërbimit

Shpërdorimi i shërbimit si vepër penale e paraparë në nenin 354 të Kodit Penal në të dhënat statistikore të Gjykatës Themelore të Tetovës rezulton e evidentuar 5 herë në periudhën 2014-2018. Për këtë vepër penale 2 herë është shqiptuar dënim me kusht, 2 herë dënim me burg dhe 1 herë ka përfunduar me akt fillestar.

Tabela 6: Shpërdorimi i detyrës zyrtare në periudhën 2014-2018 në Gjykatën Themelore në Tetovë.

Shpërdorimi i shërbimit - neni 354		
Viti	Nr.rasteve të evidentuara	Lloji i dënimit
2016	1	Dënim me kusht
2017	2	Dënim me kusht
		Dënim me burg
2018	2	Akt fillestar(kërkesa, propozimi)
		Dënim me burg

Nga tabela e paraqitur vërejm se për këtë vepër penale në vitet 2014 dhe 2015 në Gjykatën Themelore të Tetovës nuk kemi asnjë rast të regjistruar. Kjo vepër penale në vitin 2016 në Gjykatën Themelore Tetovë është evidentuar vetëm një herë dhe për të është shqiptuar dënim me kusht. Në vitin 2017 kemi 2 raste të evidentuara të shpërdorimit të shërbimit dhe paraqiten dy lloje dënimesh, një herë dënim me kusht dhe një herë dënim me burgim. Në vitin 2018 janë evidentuar 2 raste të shpërdorimit të shërbimit, njëri ka përfunduar me akt fillestar, kurse njëri me dënim me burg.

4. Raset nga praktika gjyqësore falsifikimi i dokumentit zyrtar

Praktika gjyqësore nuk njeh shumë raste të veprës penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar edhe pse konsiderohet si një ndër veprat më të shpeshta penale. Kjo vepër penale nuk paraqitet dhe nuk është e evidentuar në statistikat e gjykaave.

Në Gjykatën Themelore të Tetovës në periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2018 vetëm një herë është pranuar lëndë për falsifikimin e dokumentit zyrtar dhe atë në vitin 2015.

Kjo vepër penale është evidentuar në regjistrin e gjykatës me numër K-11/15. Për këtë vepër penale Gjykata Themelore Tetovë ka shqiptuar masë alternative dënim me kusht me ç'rast dënimi me burg prej 3 muaj nuk do të ekzekutohet në qoftë se brenda dy viteve nuk do të kryejë vepër të re penale.

E akuzuar për kryerje të kësaj veprë penale ishte shtetësja e RMV-së L. C, e lindur në vitin 1975 me vendbanim në Tetovë. E akuzuara ishte e martuar, nënë e dy fëmijëve, nuk ka qenë e gjykuar më parë dhe ndaj saj ndaj saj nuk është zhvilluar procedurë tjetër.

Përgatitja shkollore e kryesës së kësaj veprë penale ishte arsim të mesëm, e punësuar në MPB Tetovë , me të hyra mujore 19.000 den.

Kryerësja e kësaj veprë penale duke shfrytëzuar pozitën si e punësuar në MPB Tetovë, ka kryer veprën penale “Falsifikim i dokumentit zyrtar” në bazë të nenit 361 paragrafi 1 të Kodit Penal dhe në bazë të kësaj i është shqiptuar masë alternative dënim me kusht.

Përfundim

Keqpërdorimi i detyrës zyrtare paraqet një fenomen të rrezikshëm i cili është në rritje të vazhdueshme. Çdo shtet përballet në mënyra të ndryshme me këtë kategori të veprave penale. Duke bërë kategorizimin e veprave penale kundër detyrës zyrtare në një kategori të veçantë, legjislati i vendit tonë si dhe i shumë vendeve tjera theksojnë rëndësinë e tyre.

Kjo vepër penale paraqet një ndër veprat më të rënda e cila dëmton rëndë interesin e përgjithshëm të shoqërisë dhe të çdo qytetari.

Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare nuk cilsohen si një fenomen i ri. Në këtë punim duke gjurmuar aspektet historike dhe krahasuse të vendit tonë me vendet fqinje vërejmë edhe ecurin e prezencës, ndjekjes dhe dënimit të kryerësve të këtyre veprave penale. Ndër vite këto vepra penale gjithmonë kanë qenë prezente dhe janë karakteristike për çdo shtet dhe çdo shoqëri në periudha të ndryshme .

Legjislacioni jon vendas gjithmonë ka inkriminuar veprat e tilla penale dhe vazhdimisht vërehen përpjekjet për reforma komform rekomandimeve të Bashimit Evropian.

Rrezikshmëria e këtyre veprave penale është evidente. Kryerësit e këtyre veprave penale përdorin apo keqpërdorin pozitën e dhënë për qëllime personale duke kaluar kufijtë e autorizimit që pozita zyrtare ua jep. Këto vepra penale gjithmonë kryhen për një qëllim të caktuar dhe atë për të përfituar ndonjë dobi të caktuar apo për ti shkaktuar dëm dikuj. Eksistojnë disa mënyra për të arritur të qëllimi i caktuar, si shfrytëzim të detyrës, tejkalim të kompetencave dhe moskryerje të detyrës.

Nga analiza dhe shtjellimi i disa veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare në këtë punim vërejmë se kryerësi i këtyre veprave penale gjithmonë paraqitet në cilsinë të personit zyrtar apo personit përgjegjës.

Këto vepra penale janë vepra penale të cilat kryhen me dashje dhe përfshijnë edhe vetëdijen dhe dëshirën e kryerësit për finalizimin e së njëjtës. Përfshirje me rastë është vepra penale e zbulimit të sekreteve zyrtare për të cilën parashihet edhe përgjegjësi penale për pakujdesi.

Në këtë tezë masteri në bazë të të dhënave solide të siguruar nga Gjykata Themelore e Tetovës është paraqitur një pasqyrë statistikore sipërfaqësore për këto vepra penale.

Ky lloj i krimit paraqitet si një ndër krimet më të fshehura, më pak të evidentuara kjo për shkak të pozitës dhe autoritetit që kanë kryerësit e këtyre veprave penale. Paprekshmëria e kryerësve bën që këto vepra penale mos zbulohen, madje edhe mos paraqiten fare në ç'rast nurmi i erët në këtë rast paraqitet shumë i lartë.

Në analizën e raporteve statistikore për periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2018 numri i përgjithshëm i lëndëve të evidentuara në Gjykatën Themelore të Tetovës është 60 vepra penale Keqpërdorim i detyrës dhe autoritetit zyrtar.

Në bazë të statistikave në vitin 2014 është shënuar numri më i madh i rasteve të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe atë 22 raste. Në periudhën katër vjeçare shënohet një rënie e numrit të veprave penale të evidentuara. Në vitin 2015 janë evidentuar 17 raste, në vitin 2016 9 raste, 4 raste në vitin 2017 dhe në vitin e fundit në vitin 2018 kemi përsëri një ritje në 8 raste të regjistruara.

Nga gjithë veprat penale që përfshihen në kapitullin e XXX të Kodit Penal, lidhur me keqpërdorim të detyrës dhe autoritetit zyrtar vetëm disa nga këto vepra janë regjistruar në regjistrin e Gjykatës Themelore të Tetovës. A don të thotë kjo që nuk janë kryer veprat e tilla penale? Praktika gjyqësore nuk njih shum raste të veprave penale të këtij kapitulli.

Nga korpusi i veprave penale të kërrij kapitulli janë evidentuar vetëm raste të veprës penale të Keqpërdorimit të pozitës dhe autorizimit zyrtar , Shkelja e ruajtjes së kufirit shtetëror, Të punuarit e pandërgjegjshëm gjatë detyrës, Shpërdorimi i shërbimit, Marrja e rryshfetit dhe Falsifikimi i dokumentit zyrtar.

Nga këto vepra, Keqpërdorimi i detyrës dhe autorizimit zyrtar në statistikat e kësaj gjykatë paraqitet më numër më të madh të rasteve.

Dënimi me kusht është dënimi më i shqiptuar në periudhën 4 vjeçare dhe atë 25 herë. Krahas dënimit me kusht janë shqiptuar edhe dënim me burg, dënim me gjobë, kemi rastet kur kryerësi është liruar nga akuza, rastet kur akuza është refuzuar dhe rastet kur vepra e kryer nuk është konsideruar si vepër penale.

Veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare paraqesin një sfidë permanente që duhet luftuar dhe parandaluar në mënyrë sa më efikase në çdo shtet e shoqëri bashkëkohore.

Keqpërdorimi i përgjegjesive të tilla, i funksioneve publike paraqet një pasqyrë për një sistem jo efikas shtetrorë dhe zvogëlon besimin e qytetarëve në një shtet ligjor dhe demokratik. Keqpërdorimi i detyrës, marrja dhe dhënia e rryshfetit paraqesin pengesat kryesore për zhvillimin e qëndueshëm ekonomik, politik dhe shoqëror.

Shtetet duhet të ndërmarrin të gjitha masat preventive dhe represive me qëllim që në mënyrë sa më efikase të luftojnë dhe parandalojnë veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut në bazë të hulumtimit të punës dhe angazhimit të institucioneve të drejtësisë mund të themi se aktivitetet e ndërmarra janë të pamjaftueshme. Puna e institucioneve është treguar joefektive dhe besimi i qytetarve në drejtësi dhe organe të drejtësisë është luhatur dhe ka humbur dhe për rifitimi kërkon një punë dhe angazhim serioz të të gjithë instancave shtetërore.

Literatura

Zejneli, Ismail, E Drejta Penale-Pjesa e posaçme, Tetovë, 2007.

Saliu, Ismet, E drejta penale e posaçme, Prishtinë, 2016.

Elezi, Ismet, E drejta penale e posaçme, Tiranë, 2004

Kambovski, Vllado, E Drejta Penale-Pjesa e Posaçme, Shkup, 2010.

Kambovski, Vllado, E Drejta Penale-Pjesa e Përgjithëshme, Shkup, 2010.

Kambovski, Vllado, Zejneli, Ismail, E drejta penale - Pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018.

Sahiti, Ejup, Zejneli, Ismail, E drejta e procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017.

Halili, Ragip, Kriminologjia, Prishtinë, 2011.

Latifi, Vesel, Kriminalistika, Prishtinë, 2014.

Latifi, Vesel dhe grup autorësh, Politika e parandalimit të krimit, Prishtinë, 2014.

Avziu, Qebir, Kriminalistika, Tetovë, 2015.

Gashi, Rexhep, Krimi i Organizuar, Prishtinë 2014.

Shegani.A, E drejta Penale e Krahasuar, Tiranë, 2002.

Zejneli Jusuf, Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë, Tetovë, 2013.

Saliu, Kurtesh, E Drejta Kushtetuese, Tetovë 2002.

Lumani, Fatmire, E Drejta Kushtetuese, Tetovë, 2014.

Grup autorësh, Kriminaliteti i organizuar-aspekte juridike, Tetovë, 2009.

Osmani, Afrim, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, (Teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik) Shkup, 2010.

Latifi, Vesel, *Luftimi i korupsionit dhe konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale*, JURIDICA, Instituti Evropian për Studime Juridike dhe Administrim Publik, Prishtinë 2011.

Haziri, Fatos, *Vështrim krahasues juridikopenal i fenomenit të shpërlarjes së parave në Kosovë dhe disa shtete të Bashkimit evropian dhe ballkanit perendimor*, JURIDICA, Instituti Evropian për Studime Juridike dhe Administrim Publik, Prishtinë 2015

I. Salihu, H. Zhitija, F.Hasani, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë, Mars 2010.

Raport studimor për veprat penale të korrupsionit dhe formave të shpërdorimit të detyrës i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, 2014.

Grup autorësh, Kriminaliteti i organizuar-aspekte juridike, Tetovë, 2009.

Doracak Për Aplikimin E Ligjit Për Mbrojtjen E Denoncuesve Në Arsimin E Lartë Në Republikën E Maqedonisë, Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Edukim, Shkup, Prill 2018

Burime të tjera:

- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, “Gazeta zyrtare e RM-së” nr.28, datë 06.02.2014.
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, nr 06/L-074, “Gazeta Zyrtare E Republikës Së Kosovës” , Nr.2, 14 Janar 2019, Prishtinë.
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, Gusht 2017.
- Kodi Penal i Republikës së Kroacisë.
- Kushtetuta e RMV-së, nr.08-4642/1, 17 Nëntor 1991.
- Ligji për policinë, Shkup, 2015.
- Ligji për gjykata, Shkup, “Gazeta zyrtare e RM-së”, nr. 07-1912/1, 2006.
- Ligji për Pokurorinë publike, “Gazeta zyrtare e RM-së”, nr.150, 12.12.2007.
- Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, “Gazeta zyrtare e RMV-së”, Janar 2019.
- Kodi Etik i Prokurorëve Publik, PPRM, nr. 725/ 14, Shkup, Dhjetor 2014.
- Kodi etikës policore, “Gazeta zyrtare e RM-së”, nr.72, 11.06.2007.
- Ligji për pengimin e korrupsionit, “Gazeta zyrtare e RMV-së”, nr, 28/02, 46/04, 126/06, 10.01.2007.
- Konventa Penale për Korrupsion, Strasburg 1999.